

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6224
E mërkurë, 27 janar 2021
çmimi 0.40 €

Reforma zgjedhore,
e domosdoshme për
t'i shmangur problemet
në zgjedhje FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP) KA VENDOSUR KUNDËR KANDIDATËVE PËR DEPUTETË QË KANË PASUR PROBLEME ME LIGJIN

VENDIMI I PZAP-it: KURTI DHE TË TJERËT, JASHTË LISTAVE PËR DEPUTETË



Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) pjesërisht ka hedhur poshtë ankesat e Lëvizjes Vetëvendosje (LV-së), mirëpo ka vërtetuar pjesën ku Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ua ndalon pjesëmarrjen në garën zgjedhore pesë deputetëve që kanë dënime të formës së prerë, përfshirë këtu edhe bartësin e listës së LV-së, Albin Kurti. Po ashtu, PZAP-i ka refuzuar kërkesën për certifikimin e 12 kandidatëve për deputetë të Nismës Socialdemokrate. Gjithashtu, vendimi i njëjtë vlen edhe për katër kandidatë të AAK-së për deputetë. Sipas PZAP-it, këta emra nuk mund të zëvendësohen me kandidatë të tjerë FAQE 5

FLET PËR "EPOKËN E RE", ENVER HOTI FAQE 4-5

NISMA NUK E KA PROBLEM KALIMIN E PRAGUT ZGJEDHOR

Anëtari i kryesisë i Nismës Socialdemokrate, njëherësh kandidat për deputet, Enver Hoti, ka thënë se kjo parti politike nuk ndikohet nga sondazhet e porositura. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se Nisma Socialdemokrate nuk e ka problem kalimin e pragut zgjedhor. Sipas Hotit, kjo parti në zgjedhjet e

14 shkurtit do t'i marrë mbi gjashtë deputetë. Ai ka folur edhe për refuzimin e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për të bashkëpunuar me Nismën Socialdemokrate në këto zgjedhje, duke e vlerësuar këtë gabim të madh të PDK-së. Hoti ka thënë se PDK-ja i ka marginalizuar figurat dhe njerëzit që vijnë nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK)



OPINION

ZGJEDHJET E JASHTËZAKONSHME, NË SITUATË TË JASHTËZAKONSHME, DËSHTIMET NË PARASHIKIME F. 8

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



AKTUALE



JANET YELLEN EMËROHET GRUAJA E PARË NË KRYE TË THESARIT AMERIKAN F. 2

PSD-ja THOTË SE PRESIDENCA ËSHTË BËRË NËNDEGË E RE E VETËVENDOSJES F. 7

EKONOMI

80 PËR QIND E QYTETARËVE BESOJNË SE LIDHJET FAMILJARE DHE PARTIAKE JANË KUSHT PËR PUNËSIM F. 8

OLMSTEAD PREMTON MBËSHTETJEN E SHBA-së PËR REALIZIMIN E PROJEKTEVE ENERGETIKE F. 9

KULTURË

PROMOVHET LIBRI "DEÇANI NËPËR SHEKUJ" F. 6



SANNINO: TURBULENCAT POLITIKE NË KOSOVË NUK I KANË NDIHMUAR DIALOGUT ME SERBINË FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Dorëhiqet kryeministri italian

ROMË, 26 JANAR - Kryeministri i Italisë, Giuseppe Conte, ka dhënë dorëheqje të martën, duke bërë një lëvizje taktike që ka si qëllim t'i maksimizojë shanset për udhëheqjen e një

qeverie të re. Conte i mbijetoi një votëbesimi në të dyja dhomat e parlamentit, javën e kaluar, pasi ish-kryeministri Matteo Renzi shkaktoi një krizë politike duke tërhequr

partinë e tij të vogël Italia Viva nga koalicioni qeverisës. Sidoqoftë, votëbesimet e lanë Conten me një shumicë të vogël dhe ai nuk mundi ta forcojë mbështetjen.



Janet Yellen emërohet gruaja e parë në krye të Thesarit Amerikan



WASHINGTON, 26 JANAR - Senati amerikan ka votuar me shumicë për ta konfirmuar Janet Yellen si gruan e parë që do ta udhëheqë Departamentin e Thesarit. Senati ka votuar me 84 vota për dhe 15 kundër, për konfirmimin e Yellenit, e cila, sipas presidentit amerikan Joe Biden, do të angazhohet për stabilizim të ekonomisë amerikane, teksa përballlet me krizën më të rëndë në dekada. Yellen është e njohur mirë në Uashington, pasi ka shërbyer

më parë edhe si gruaja e parë në krye të Rezervave Federale, dhe si udhëheqëse e këshilltarëve për ekonomi në Këshillin e Shtëpisë së Bardhë. Si prioritet të parë, Yellen, 74-vjeçare, pritet të ketë hartimin e politikave ekonomike, teksa Shtetet e Bashkuara përballen me pandeminë e koronavirusit. Në mesin e planeve të Bidenit gjendet edhe miratimi në Kongres i paketës së ndihmës në vlerë të 1.9 trilion dollarëve. Kjo paketë synon t'i rrisë fondet

për vaksinim, të shtojë 400 dollarë më tepër si përfitim javor për amerikanët që kanë humbur vendet e punës, dhe të sigurojë para të gatshme në vlerë prej 1 400 dollarëve për shumicën e njerëzve. Administrata Biden beson se fondet shtesë janë të nevojshme për ta parandaluar rënien spirale të ekonomisë. Vetë Bideni ka thënë se negociatat me republikanët në Kongres mund të zgjasin për dy javë të tjera.

BE-ja kërkon ndihmën e ShBA-së për mediat sociale

BRUKSEL, 26 JANAR - Bashkimi Evropian ka kërkuar ndihmën e Shteteve të Bashkuara për ta frenuar fuqinë e mediave sociale, duke krijuar rregulla globale për funksionimin e tyre. Thirrja u bë nga presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen. "Platformat në internet kanë ndikim jo vetëm në konkurrencën e lirë dhe të ndershme, por edhe në demokracitë tona, sigurinë tonë

dhe në cilësinë e informacionit", ka thënë von der Leyen të martën në Forumin Ekonomik Botëror. Sipas saj, kompanitë e internetit duhet ta marrin përgjegjësinë për mënyrën se si ato shpërndajnë, promovojnë dhe fshijnë përmbajtjen. Kancelarja gjermane Angela Merkel, në fjalën e saj iu referua fuqisë së kompanive të mediave sociale. "Pasi kemi tendencë të monopolit, natyrisht për këtë

duhet të flasim në nivel ndërkombëtar", ka deklaruar ajo. Rreth 2 000 udhëheqës politikë dhe të biznesit po marrin pjesë në diskutimet në kuadër të Forumit Ekonomik Botëror. Takimi po mbahet përmes internetit për shkak të pandemisë së Covid-19, në vend të mbledhjes së zakonshme në vendpushimin malor zviceran të Davosit.



"Facebook"-u ndërpret një bisedë online të Netanyahu



JERUSALEM, 26 JANAR - Rrjeti social "Facebook" ka njoftuar se ka ndërprerë një bisedë online në faqen e kryeministrit izraelit Benjamin Netanyahu për, siç tha, shkelje të politikave të rrjetit social. Postimi u kërkoi ndjekësve të ofrojnë detaje të miqve dhe të afërmeve të tyre, të

moshës 60 vjeç e lart, të cilët nuk e kanë marrë ende vaksinën kundër koronavirusit. Në të thuhej se Netanyahu mund t'i thërrasë për t'i bindur ata. "Facebook"-u ka njoftuar se kërkesa e tillë shkel politikën në lidhje me të dhënat private mjekësore. "Në përputhje me

politikën tonë të privatësisë, ne nuk lejojmë përmbajtje që ndan ose kërkon informacione mjekësore të njerëzve", ka njoftuar "Facebook". Kjo nuk është hera e parë që llogaria e Netanyahu në "Facebook" ka probleme me shkelje të rregullave.

Bideni shfuqizon ndalesën për ushtarët transgjorë

WASHINGTON, 26 JANAR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Joe Biden, ka shfuqizuar vendimin e paraardhësit të tij, Donald Trump, për t'i ndaluar amerikanët transgjorë që t'i bashkohen ushtrisë. Trump e ka shpallur këtë ndalesë gjatë vitit të parë si president.

"Shërbyesit transgjorë nuk do t'i nënshtrohen më mundësisë së shkarkimit ose ndarjes në bazë të identitetit gjinor", është bërë me dije në deklaratën e Shtëpisë së Bardhë. Sipas të dhënave të Departamentit Amerikan të Mbrojtjes, në vitin 2019 kanë

qenë 8 980 ushtarë transgjorë në detyrë. "Presidenti Biden beson se identiteti gjinor nuk duhet të jetë pengesë për shërbimin ushtarak dhe se forca e Amerikës gjendet në shumëllojshmërinë e saj", theksohet në deklaratën e Shtëpisë së Bardhë.



Mbahet tryeza “Reforma zgjedhore dhe zgjedhjet: a është reforma zgjedhore prioritet në programet e partive politike?”

Reforma zgjedhore, e domosdoshme për t'i shmangur problemet në zgjedhje

Përfaqësues të Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) kanë prezantuar të martën analizën e politikave përmes së cilës konsiderojnë se një reformë zgjedhore është e domosdoshme për të mėnjanuar problemet e vazhdueshme në proceset zgjedhore. Po ashtu, GLPS-ja ka konsideruar se Projektligji për Financimin e Partive Politike duhet të mbetet prioritet për qeverinë në ardhje dhe i njëjti duhet të mbetet sipas rekomandimeve të shoqërisë civile dhe Komisionit të Venecias

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 JANAR - Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka mbajtur tryezën e diskutimit me temë “Reforma zgjedhore dhe zgjedhjet: a është reforma zgjedhore prioritet në programet e partive politike?”.

Panelistë në këtë diskutim online ishin drejtori i Zyrës për Regjistrimin dhe Certifikimin e Partive Politike (RPPC), Ylli Buleshka, kandidati për deputet nga Lëvizja Vetëvendosje (LV), Adnan Rustemi, dhe kandidati për deputet nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Shkëlzen Hajdini.

Përfaqësues të GLPS-së kanë prezantuar analizën e politikave në të cilën konsiderojnë se një reformë zgjedhore është e domosdoshme për t'i mėnjanuar problemet e vazhdueshme në proceset zgjedhore. Në të njëjtën

linjë GLPS-ja konsideroi se Projektligji për Financimin e Partive Politike duhet të mbetet prioritet për qeverinë në ardhje dhe i njëjti duhet të mbetet sipas rekomandimeve të shoqërisë civile dhe Komisionit të Venecias. Drejtori i Zyrës për Regjistrim dhe Certifikim të Partive Politike, Ylli Buleshka, ka theksuar se është shumë e rëndësishme se para se të fillojë një proces reformues duhet të bëhet një vlerësim i tërësishëm me të gjitha palët e interesit, përfshirë këtu edhe institucionet relevante, në mënyrë që të kontribuohet njëjtë në këtë proces. Po ashtu, ai ka mirëpritur iniciativën, por edhe kontributin e shoqërisë civile për reformat e iniciuara për partitë politike, duke konsideruar një iniciativë të tillë si shumë të rëndësishme drejt rritjes së transparencës financiare.

Në vazhdim, kandidati për deputet nga Lidhja Demokratike

e Kosovës, Shkëlzen Hajdini, ka theksuar nevojën për ligje të aplikueshme në praktikë. Ai konsideroi se ekziston një nevojë e madhe për rishikim të Projektligjit për Financimin e Partive Politike, duke gjetur një konsensus të gjerë mes partive ekzistuese. Sipas tij, projektligji aktual ngërthen në vete procedura që janë vështirë të aplikueshme. Ai ka shtuar se tashmë është e evidente se financimi i partive politike ballafaqohet me mungesë transparence, dhe mbetet parakusht që të propozohen ndryshimet e nevojshme që

projektligji aktual të jetë i zbatueshëm nga i gjithë spektri politik.

Ndërkaq kandidati për deputet nga Lëvizja Vetëvendosje, Adnan Rustemi, vuri theksin mbi politizimin e tejskajshëm me procesin e reformës zgjedhore duke potencuar se asnjëherë nuk ka ekzistuar një seriozitet i dëshiruar, por është përdorur më shumë për interesa politike, sidomos gjatë fushatave zgjedhore. Ndër të tjera, ai tha se vëmendja duhet të vihet në administrimin e proceseve zgjedhore sesa në reformën e sistemit zgjedhor. Ai ka shtuar se

është shumë e rëndësishme të sigurohen kapacitetet e duhura profesionale të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe, ndër të tjera, të sigurohet pavarësia e Zyrës për Regjistrimin dhe Certifikimin e Partive Politike.

Si përfundim, GLPS u bëri thirrje të gjitha partive politike në Kosovë, që të angazhohen për arritjen e një konsensusi të përgjithshëm, për ta çuar vendin drejt një reforme të mirëfilltë zgjedhore dhe, përfundimisht, të bëjnë përpjekje serioze për ngritjen e transparencës financiare të partive politike.

Sannino: Turbulencat politike në Kosovë nuk i kanë ndihmuar dialogut me Serbinë

PRISHTINË, 26 JANAR - Sekretari i Përgjithshëm i Shërbimit Evropian për Punë të Jashtme, Stefano Sannino, ka thënë të martën se turbulencat politike në Kosovë nuk i kanë ndihmuar procesit të dialogut me Serbinë, mirëpo zyrtarët evropianë besojnë se dialogu mund të rinisë shpejt. “Ballkani Perëndimor do të vazhdojë të jetë lart në agjendën tonë. Nuk kam dyshim për këtë gjë. Do ta them shumë qartë: Ky është biznes i papërfunduar. Ne kemi përgjegjësi të veçantë për rajonin. Nuk e përballojmë dot që të mos vazhdojmë punën që kemi nisur”.

Sipas tij, mbështetja që po ofron Miroslav Lajčak si i dërguar i posaçëm në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë është shumë i rëndësishëm dhe se puna e të ish të dërguarit amerikan për këto bisedime,

Richard Grenell, nuk ka qenë ndihmuese. “Nëse do të kisha qenë i sinqertë me ju, puna e Grenellit nuk ka qenë ndihmuese. Më shumë se kaq, nuk ka qenë në interesin e rajonit. Ka qenë në interes të Shteteve të Bashkuara dhe idesë që kanë pasur. Prandaj ne duhet të udhëheqim. Mirëpo për të qenë në udhëheqje në Ballkanin Perëndimor, ne duhet të jemi aktivë në procesin e zgjerimit sepse ajo është perspektiva”, ka deklaruar Sannino.

Ai ka vlerësuar se ndonëse ky proces ndonëse është kompleks, nuk përbën arsye që të BE-ja të mos jetë e angazhuar fuqishëm dhe e përkushtuar për Ballkanin Perëndimor. Dialogu politik në mes të Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, ka nisur më 2011.

Takimi i fundit në mes të krerëve



shtetërorë të këtyre vendeve është zhvilluar në shtator të vitit të kaluar. Prej atëherë nuk është zhvilluar takim i nivelit të lartë, derisa në BE kanë thënë se arsyeja mbrapa mungesës së

takimeve është pandemia e koronavirusit. Arsye tjetër e mosmbajtjes së takimeve tani është edhe shpallja jokushtetuese e Qeverisë së udhëhequr nga kryeministri

Avdullah Hoti në Kosovë. Deri në zgjedhjen e Qeverisë së re të Kosovës, Brukseli zyrtar ka paralajmëruar se nuk do të ketë takime në kuadër të dialogut. (Rel)



FLET PËR "EPOKËN E RE", ENVER HOTI

Nisma nuk e ka problem kalimin e pragut zgjedhor

Anëtari i kryesisë i Nismës Socialdemokrate, njëherësh kandidat për deputet, Enver Hoti, ka thënë se kjo parti politike nuk ndikohet nga sondazhet e porositura. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se Nisma Socialdemokrate nuk e ka problem kalimin e pragut zgjedhor. Sipas Hotit, kjo parti në zgjedhjet e 14 shkurtit do t'i marrë mbi gjashtë deputetë. Ai ka folur edhe për refuzimin e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për të bashkëpunuar me Nismën Socialdemokrate në këto zgjedhje, duke e vlerësuar këtë gabim të madh të PDK-së. Hoti ka thënë se PDK-ja i ka marginalizuar figurat dhe njerëzit që vijnë nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK)

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 26 JANAR - Anëtari i kryesisë i Nismës Socialdemokrate, njëherësh kandidat për deputet, Enver Hoti, është shprehur i bindur për suksesin e kësaj partie në zgjedhjet e 14 shkurtit.

Ai ka thënë se kjo parti nuk e ka problem kalimin e pragut zgjedhor prej 5-përqindësh.

Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Hoti ka deklaruar se kjo parti do t'i ketë më shumë se gjashtë deputetë në Kuvend. "Natyrshisht se ne fare nuk do ta kemi problem kalimin e pragut

zgjedhor. Sipas të dhënave tona që kemi nga terreni dhe analizës sonë që kemi bërë, ne do të kemi në Kuvendin e Kosovës më shumë se gjashtë deputetë. Pra, ne nuk jemi fare të ndikuar se çfarë po raportohet", ka thënë Hoti.

Ai ka mohuar sondazhet e fundit të cilat thonë se kjo parti nuk do ta kalojë pragun zgjedhor.

Hoti ka thënë se këto sondazhe janë të porositura dhe kanë marzhë të lartë të gabimit për partitë e vogla. "Ne nuk ndikohemi nga sondazhet, sepse ato sondazhe janë të porositura dhe janë me tendenca. Të gjithë ata që merren me sondazhe e dinë që marzha e gabimit të

sondazheve për partitë e vogla është shumë më e lartë se te partitë e mëdha", është shprehur ai.

Hoti ka folur edhe për refuzimin e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për të bashkëpunuar me Nismën në këto zgjedhje. Ai ka thënë se ky është një gabim i madh që ka bërë PDK-ja. "Nisma ka pasur një gatishmëri për të bashkëpunuar me PDK-në për shkak të veprimeve të Gjykatës Speciale dhe sfidave të cilat e presin këtë kategori të njerëzve që ne përfaqësojmë. Por, PDK-ja e humbi rastin dhe tani jemi në garë ndaras. Ne aspak nuk jemi të penduar për vendimin e marrë.

Kjo i takon të kaluarës. Tani ne jemi në detyrën tonë për të komunikuar me elektoratin", ka deklaruar ai.

Sipas Hotit, PDK-ja i ka marginalizuar figurat dhe njerëzit që vijnë nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës. "Rezultati i 14 shkurtit do të tregojë se PDK-ja ka bërë një gabim shumë të madh. PDK-ja ka një problem brenda vetvetes i cili po shihet se është një tentativë për t'i marginalizuar figurat dhe njerëzit që vijnë nga Ushtria Çlirimtare të Kosovës. Kjo për mua është për keqardhje dhe shqetësuese. Një marginalizim i tillë është duke ndodhur dhe kjo vërehet kushdo që e shikon listën zgjedhore të PDK-së", ka thënë Hoti.

"Epoka e re": Z. Hoti, Nisma ka filluar aktivitetet elektorale në terren. Si po ju ecën parafushata?

Hoti: Një nga vendimet më të mira të Nismës Socialdemokrate prej vitit 2014 deri më tani është vendimi për të shkuar vetë në zgjedhje. Ky vendim ka reflektuar fuqinë dhe disponimin e elektoratit për të marrë pjesë në

zgjedhje. Ky vendim ka mobilizuar votuesit dhe strukturat e Nismës. Tani është një disponim jashtëzakonisht i madh i strukturave të Nismës dhe aktivistëve të saj, i cili garanton sukses të jashtëzakonshëm të Nismës në zgjedhjet e 14 shkurtit. Pra, vendimi i lidhshëm të Nismës Socialdemokrate që të shkojë si subjekt i vetëm politik në këto zgjedhje ka qenë vendim i qëlluar.

"Epoka e re": Pritjet ishin që Nisma të shkojë në këto zgjedhje me PDK-në, por një gjë e tillë nuk ndodhi. Si e keni parë mosgatishmërinë e PDK-së për të bashkuar në bashku në zgjedhje?

Hoti: Nisma ka pasur një gatishmëri për të bashkëpunuar me PDK-në për shkak të veprimeve të Gjykatës Speciale dhe sfidave të cilat e presin këtë kategori të njerëzve që ne përfaqësojmë. Por, PDK-ja e humbi rastin dhe tani jemi në garë ndaras. Ne aspak nuk jemi të penduar për vendimin e marrë. Kjo i takon të kaluarës. Tani ne

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka vendosur kundër kandidatëve për deputetë që kanë pasur probleme me ligjin

Vendimi i PZAP-it: Kurti dhe të tjerët, jashtë listave për deputetë

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) pjesërisht ka hedhur poshtë ankesat e Lëvizjes Vetëvendosje, mirëpo ka vërtetuar pjesën ku Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ua ndalon pjesëmarrjen në garën zgjedhore pesë deputetëve që kanë dënime të formës së prerë, përfshirë këtu edhe bartësin e listës së LV-së, Albin Kurti. Po ashtu, PZAP-i ka refuzuar kërkesën për certifikimin e 12 kandidatëve për deputetë të Nismës Socialdemokrate. Gjithashtu, vendimi i njëjtë vlen edhe për katër kandidatë të AAK-së për deputetë. Sipas PZAP-it, këta emra nuk mund të zëvendësohen me kandidatë të tjerë

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 26 JANAR - Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka marrë vendim që të certifikohen kandidatët për deputetë të Lëvizjes Vetëvendosje, Nismës Socialdemokrate dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, me përjashtim të atyre që kanë pasur probleme me ligjin.

Në vendimet e publikuara të martën, PZAP-i ka njoftuar se ka refuzuar pjesërisht apelin e Lëvizjes Vetëvendosje. Ky organ ka vërtetuar vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për

moscertifikimin e gjashtë kandidatëve për deputetë të kësaj partie: Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Liburn Aliu, Bajram Mavriqi dhe Labinotë Demi-Murtezi. "Pranohet pjesërisht rekomandimi i ZRPPC-it, certifikohet lista e kandidatëve për deputetë të kësaj partie, me përjashtim të kandidatëve të cekur", thuhet në njoftim për media, në të cilin shtohet se "kandidatët e cekur në pikën një të diapozitivit të këtij vendimi, nuk mund të zëvendësohen me kandidatë të tjerë". Sipas ligjit, të gjitha palët që nuk janë të kënaqura me vendimet e PZAP-it mund t'i drejtohen Gjykatës

Supreme. Palët brenda 24 orëve mund t'i dorëzojnë ankesat në Supreme dhe Gjykata më pas ka afat 72 orë që t'u përgjigjet ankesave të paraqitura.

Më 3 janar 2018, deputetët e atëhershëm të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Faton Topalli dhe Donika Kadaj-Bujupi, u dënuan me kusht për hedhjen e gazit lotsjellës në ambientet e Kuvendit të Kosovës. Në shtator të po atij viti, Gjykata e Apelit i ka vërtetuar dënimet e shqiptuara nga gjykata e shkallës së parë.

Paneli, po ashtu, ka vendosur që Nisma Socialdemokrate të certifikohet si parti politike për

zgjedhjet e 14 shkurtit, por ka refuzuar kërkesën për certifikimin e 12 kandidatëve për deputetë: Vesel Krasniqi, Besnik Berisha, Filloreta Bytyçi, Valentina Alija, Xhafer Berisha, Aziz Thaçi, Musa Fetahaj, Hasime Daka, Fatmir Gërdellaj, Vehbi Avdullahaj, Endrit Shala dhe Adrian Nokaj. Si në rastin e LV-së, edhe për Nismën Socialdemokrate PZAP-ja ka refuzuar rekomandimin e Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim, që kishte dërguar në KQZ, me rekomandimin që kandidatët që kanë probleme me ligjin, të certifikohen për zgjedhje. Edhe kandidatët e Nismës që janë cekur në vendim nuk mund të zëvendësohen me kandidatë të tjerë.

Vendimi i njëjtë vlen edhe për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, ku PZAP-i ka thënë se kandidatët për deputetë: Shemsedin Dreshaj, Gani Dreshaj, Rrahim Ajeti dhe Shqipe Kastrati nuk mund të certifikohen dhe as të zëvendësohen me kandidatë të tjerë. Ndërkaq, kandidatët e tjerë në listën për garë zgjedhore të këtij subjekti do të certifikohen për

zgjedhjet e 14 shkurtit. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka pohuar se ky institucion do t'i respektojë të gjitha vendimet e marra nga PZAP-i. "Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të veprojë në përputhje me vendimet e PZAP-it dhe do të presim sepse në fund të këtyre vendimeve ka këshilla juridike, sipas të cilave, është e lejuar ankesa në Gjykatën Supreme", ka deklaruar Elezi në një prononcim për media.

Në mbledhjen e mbajtur më 22 janar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve votoi për të mos certifikuar listat me kandidatë për deputetë të Lëvizjes Vetëvendosje, Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nismës Socialdemokrate dhe disa parti të komuniteteve joshumicë. Në këtë mbledhje Nisma Socialdemokrate nuk u certifikua as si parti.

Ky vendim i KQZ-së nxiti reagime të shumta të partive politike, pasi vetë Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim kishte rekomanduar që të certifikohen listat zgjedhore të të gjitha partive. Gjatë seancës së 22 janarit anëtarët e KQZ-së miratuan listat me kandidatë që nuk ishin ndesh me ligjin apo të atyre partive, që kishin zëvendësuar emrat në listat e tyre pas verifikimit të kryer nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, publikuar dhjetorin e kaluar, lidhur me zgjedhjen e Qeverisë së Kosovës, drejtuar nga Avdullah Hoti, KQZ-ja ka ndërmarrë një proces të verifikimit të kandidatëve për deputetë, për të parë nëse ata nuk kanë probleme me ligjin.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në një përgjigje dërguar KQZ-së më herët gjatë këtij muaji, ka thënë se 47 kandidatë për deputetë kanë probleme me ligjin. Aktgjykimi i Kushtetueses, por edhe neni 29 i Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, thotë se kandidat për deputet nuk mund të jetë një person i cili gjatë tri vjetëve të fundit ka qenë i dënuar me vendim të formës së prerë.



jemi në detyrën tonë për të komunikuar me elektoratin.

"Epoka e re": Mendoni se ka gabuar PDK-ja që nuk ka bashkëpunuar me Nismën?

Hoti: Rezultati i 14 shkurtit do të tregojë se PDK-ja ka bërë një gabim shumë të madh. PDK-ja ka një problem brenda vetvetes i cili po shihet se është një tentativë për t'i marginalizuar figurat dhe njerëzit që vijnë nga Ushtria Çlirimtare të Kosovës. Kjo për mua është për keqardhje dhe shqetësuese. Një marginalizim i tillë është duke ndodhur dhe kjo vërehet kushdo që e shikon listën

zgjedhore të PDK-së. Elektorati që është i pjekur dhe me vetëdije, besoj se do ta vërejë këtë. Elektorati që vjen nga një trashëgimi historike dhe patriotike e kombit tonë, është duke ardhur në Nisma Socialdemokrate. Ky zë përmbledh të gjitha vlerat historike të kombit tonë, në të gjitha periudhat. Pra, është një zë i cili garanton dhe siguron të gjithë qytetarët e vendit se dinjitetshëm do t'i mbrojmë këto kategori të vlerave kombëtare. Duke mbrojtur këto kategori, mbron interesin e vendit, subjektivitetin e Kosovës dhe të ardhmen tonë të

sigurt. Prandaj, ne jemi të përqendruar në këtë objektiv.

"Epoka e re": Siç kemi parë në disa sondazhe, Nisma do ta ketë vështirë kalimin e pragut zgjedhor. Cili është koment i juaj rreth këtyre sondazheve?

Hoti: Ne nuk ndikohemi nga sondazhet, sepse ato sondazhe janë të porositura dhe janë me tendencë. Të gjithë ata që merren me sondazhe e dinë që marzha e gabimit të sondazheve për partitë e vogla është shumë më e lartë se te partitë e mëdha. Prandaj, edhe këto sondazhe të porositura po tregojnë që Nisma ka një rritje

permanente. Kështu që, zgjedhjet e 14 shkurtit do të tregojnë se ato sondazhe janë të gabueshme dhe ne nuk ndikohemi nga to. Ne jemi të fokusuar në synimin tonë i cili përfaqëson vlerat më të mundshme. Nisma ka projektim më të mirë të mundshëm në këto zgjedhje, prandaj jemi të bindur që ky projekt do të gjejë një mbështetje të madhe te qytetarët e Kosovës. Ne do t'i kalojmë të gjitha këto kriza të cilat po përpiqen të na i imponojnë dhe improvizojnë disa eksponentë të ndryshëm politikë.

"Epoka e re": Cilat janë pritjet

tuaja nga këto zgjedhje?

Hoti: Natyrisht se ne fare nuk do ta kemi problem kalimin e pragut zgjedhor. Sipas të dhënave tona që kemi nga terreni dhe analizës onë që kemi bërë, ne do të kemi në Kuvendin e Kosovës më shumë se gjashtë deputetë. Pra, ne nuk jemi fare të ndikuar se çfarë po raportohet. I kisha lutur edhe mediat që të bëjnë raportime reale të situatës në terren dhe jo të bien pre e propagandave të partive të ndryshme. Parullat me bazë bolshevike duhet të kemi kujdes dhe t'i refuzojmë, sepse ato po paraqesin frikë dhe autoritarizëm në vend.

Përfundojnë punimet në disa nënkalime në kryeqytet

PRISHTINË, 26 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka postuar fotografi në llogarinë e vet në "Facebook" të punimeve të nënkalimeve në Kalabri, në Dardani, te Xhamia e Llapit dhe në Bardhosh. "Arti në hapësirat publike i jep jetë Prishtinës urbane e kur aplikohet në

hapësirat e nënkalimeve, i bën më atraktive për t'i shfrytëzuar. Tashmë kanë përfunduar të gjitha punimet e renovimit të nënkalimit në Kalabri përballë Qendrës Klinike Universitare, pjesë e projektit të Drejtorisë për Shërbime Publike që filloi vitin e kaluar. Punime për rregullim dhe renovim po

bëhen edhe te nënkalimet në Kalabri/Dardania, te Xhamia e Llapit dhe në Bardhosh. Shfrytëzimi i nënkalimeve është i rëndësishëm dhe ndikon në rritjen e sigurisë të këmbësorëve, sidomos në pjesët e Prishtinës ku kemi qarkullim të madh të trafikut", ka thënë kryetari Ahmeti.



Lumi Mirusha del nga shtrati

MALISHEVË, 26 JANAR (ER) - Si pasojë e reshjeve të mëdha të shiut dhe të borës, është rritur niveli i ujit në lumin Mirusha dhe në rrjedhat e tjera të ujërave, duke shkaktuar daljen nga shtrati të lumit, kryesisht në prona bujqësore, por edhe në rrugë. "Me këtë rast rruga Mirushë - Gurbardh është bllokuar dhe vështirësi ka edhe në akset rrugore Malishevë - Kijevë, Malishevë - Banjë dhe Turjakë - Bubël, ndërsa rrugët në malet e Berishës janë të kalueshme,

pasi është larguar bora nga rrugët", ka njoftuar Komuna e Malishevës. Në këtë njoftim theksohet se të gjitha ekipet emergjente janë në terren duke menaxhuar situatën. "Momentalisht, në rrugët ku ka probleme, banorët mund t'i përdorin rrugët alternative dhe situata është e menaxhueshme dhe deri më tani situata nuk paraqet rrezik por, pavarësisht prej kësaj, ekipet përgjegjëse janë në gatishmëri të plotë", ka njoftuar Komuna e Malishevës.



Promovohet libri 'Deçani nëpër shekuj'



Deçan, 26 janar (ER) - Në sallën e Asamblesë Komunale në Deçan të martën është bërë promovimi i librit "Deçani nëpër shekuj" i autorit Faton Mehmetaj.

Libri "Deçani nëpër shekuj" është libër historik, por është edhe një bildën apo guidë e

Deçanit, ku paraqitet historiku mijëvjeçar i Deçanit, kultura, trashëgimia, lashtësia, tradita, turizmi dhe bukuritë natyrore të Deçanit. Po ta lexosh këtë libër është e pamundur që të mos e vizitosh Deçanin.

Në këtë libër shpaloset realiteti

shqiptar i krijuar gjatë shekujve, tradita, kullat, veshjet, ritet e vjetra pagane të ruajtura me shekuj, kultura shpirtërore, rrënojat e vendbanimeve të lashta, kishat, kështjellat, rrugët e vjetra, historiku i Manastirit të Deçanit, kuvendet, duke filluar

nga ai i Verrave të Llukës 1910, Kuvendi i Junikut 1912, Kuvendi i Pajtimt të Gjaqeve 1990 e kuvende të tjera. Po në këtë libër shpaloset historiku i Deçanit nga periudhat e hershme të antikitetit e deri në ditët e sotme. Të pranishëm në këtë promovim

ishin kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, nënkryetari Sami Cacaj, poetë, shkrimtarë, historianë, publicistë, asamblistë, veteranë e invalidë të luftës së UÇK-së dhe qytetarë.

Bulliqi vizitoi lagjet e prekura nga vërshimet në qytet

PODUJEVË, 26 JANAR (ER) - Reshjet e shiut dhe të borës kanë bërë që sërish të ketë vërshime në disa zona të Komunës së Podujevës. Për ta parë nga afër gjendjen e krijuar, kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, së bashku me drejtorin e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim (DShPMSH), Fevzi Jetullahu, dhe drejtorin e Inspeksionit, Ajet Potera, kanë vizituar pjesën e qytetit te Lagja "Shala" dhe

"Tovërlanët" ku, si pasojë e ngushtimit të shtratit të përroskës dhe daljes së saj nën rrugën magjistrale, uji ka vërshuar. Në këtë zonë që nga mëngjesi ekipi emergjent i komunës dhe kompania e angazhuar kanë intervenuar për hapjen e shtratit të përroskës. Gjithashtu, kryetari Bulliqi ka vizituar edhe Lagjen "Kërtokët", ku përroska që kalon andej ka dalë nga shtrati. Gjatë vizitës në terren kryetari

Bulliqi tha se Komuna e Podujevës, ashtu si edhe para dy javësh, ka angazhuar të gjitha kapacitetet për t'u dalë në ndihmë banorëve në zonat që preken nga vërshimet. Shtabi Emergjent për Mbrojtje dhe Shpëtim, të cilin e udhëheq nënkryetarja Marigona Lahu, do të jetë vazhdimisht i mobilizuar me qëllim të koordinimit ndërinstucional dhe veprimeve të përbashkëta konform situatës së krijuar.



PSD-ja thotë se Presidenca është bërë nëndegë e re e Vetëvendosjes

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 26 JANAR - Partia Socialdemokrate (PSD) ka zhvilluar të martën një aksion simbolik para Kuvendit të Kosovës përmes të cilit e ka shpallur Presidencën nëndegë të Lëvizjes Vetëvendosje. Pjesë e këtij aksioni ishte edhe lideri i kësaj partie, Dardan Molliqaj. Zyrta i PSD-së, Nol Nushi, ka thënë se ushtruesja e detyrës e presidentit, Vjosa Osmani, ka kthyer veturat e Presidencës në vetura të partisë. "Zyra prapa nesh është objekti që ka shërbyer si zyrë e Presidencës së Republikës së Kosovës, por kohët e fundit kjo zyrë është shndërruar në një nëndegë të partisë Vetëvendosje. Prandaj sot e përruam zyrtarisht diçka që tashmë po dihet, por s'po e thonë. Përvoja jonë si qytetarë me institucione shtetërore të shndërruara në vegla të partive nuk është e mirë. Është kjo përvojë që ka rritur mosbesimin dhe pakënaqësinë qytetare. Vjosa Osmani, si u. d. e Presidencës, përdori këtë detyrë që ta themelojë të ashtuquajturën

Lista Guxo. Ajo guxoi që të punësojë në Presidencë persona të cilët disa ditë më pas i paraqiste si ardhje të reja në listën e saj. Ajo guxoi që të shpërndajë paga shtesë për punëtorët e Presidencës, veprime këto që deri vonë i quante abuzive. Veturat e Presidencës janë bërë vetura të partisë", ka thënë Nushi.

Ai ka theksuar se kemi qenë dëshmitarë se si institucionet e shtetit janë kapur më herët. "Tash jemi para një mendësie të re. Duke e pretenduar një kredo morale, Kurti po dëshiron t'i marrë krejt dhe këtu Vjosa po shërben si instrument. Në emër të çkapjes do të ndodhë një instalim i ri i të besuarve të liderit në pozita kyçe shtetërore. Në anën tjetër, Osmani, e përshtatur në mendësinë totalitariste të Kurtit, po përdor metodat e regjimit të vjetër siç janë shantazhi dhe kërcënimi. Kjo do ta cenojë demokracinë dhe lirinë, prandaj sigurisht se do të ketë edhe rezistencë", ka deklaruar Nushi.

Ndaj aktivitetit të Partisë Socialdemokrate (PSD) ka reaguar Presidenca. "U. d.



presidentja e Kosovës, dr. Vjosa Osmani, sipas ligjit, obligohet të lëvizë me veturë të Policisë së Kosovës dhe nën mbrojtjen 24-orëshe. As presidentja e as stafi i saj nuk përdorin vetura të

Presidencës. Të gjitha veturat e Presidencës çdo ditë janë në parking, ndaj pretendimet e PSD-së janë të pavërteta dhe tendencioze. Rivaliteti politik nuk duhet të përdoret për diskreditim

të institucioneve të shtetit. Përgjegjësia që të ruhet integriteti i institucioneve shtetërore dhe drejtuesve të tyre është e të gjithëve", thuhet në reagimin e Presidencës.

Shërohen nga Covidi edhe 256 pacientë në Kosovë



PRISHTINË, 26 JANAR (ER) - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë janë testuar gjithsej 1 842 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 288 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar pesë raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi. Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Gjilan një rast (90 vjeç), Malishevë një rast (78 vjeç), Pejë një rast (88 vjeç), Prishtinë një rast (71 vjeç) dhe Prizren një rast (82 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 58 687 raste nga 223 505

persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 471 raste të të vdekurve.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 256 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 51 337 raste, kurse numri i rasteve aktive është 5 879. Rastet pozitive me Covid janë nga komunat: Prishtinë 110 raste, Podujevë 27 raste, Pejë 24 raste, Gjakovë 20 raste, Deçan 17 raste, Gjilan 15 raste, Suharekë 13 raste, Ferizaj 11 raste, Klinë 7 raste, Lipjan 6 raste, Fushë-Kosovë 5 raste, Malishevë 5 raste, Kamenicë 4 raste, Rahovec 4 raste, Viti 4 raste, Prizren 3 raste, Istog 2 raste, Mitrovicë 2 raste, Shtime 2 raste dhe me nga një rast komunat Drenas, Graçanicë, Hani i Elezit, Junik, Kaçanik, Obiliq dhe Shtërpçë.

Hoti angazhohet për financimin e rregullt të shoqatave të cilat ofrojnë shërbime publike

PRISHTINË, 26 JANAR (ER) - Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka pritur të martën në takim përfaqësuesit e shoqatave "Handikos", "Down Syndrome Kosova", "SOS Fshatrave të Kosovës", si dhe përfaqësuesit e strehimoreve të Kosovës. Në këtë takim kryeministri Hoti propozoi që të shqyrtohen të gjitha rrugët ligjore dhe me të

gjitha shoqatat të cilat ofrojnë shërbime publike për grupe të caktuara, të hartohen marrëveshje kornizë trevjeçare për financimin e tyre. Qëllimi i hartimit të marrëveshjes kornizë është sigurimi i financimit të rregullt për të gjitha shoqatat që ofrojnë shërbime publike, të cilat qeveria dhe institucionet

e tjera shtetërore nuk kanë kapacitet t'i ofrojnë. Nisma e kryeministrit Hoti, për hartimin e marrëveshjes kornizë trevjeçare për financimin e rregullt të shoqatave të cilat ofrojnë shërbime publike për grupe të caktuara, u vlerësua si vendosje e standardeve të reja në bashkëpunimin e këtyre shoqatave me qeverinë.



80 për qind e qytetarëve besojnë se lidhjet familjare dhe partiake janë kusht për punësim



Në diskutimin virtual me temë “Rekrutimet (jo)meritore në sektorin publik: a do ta ndryshojnë institucionet e reja rreth vicioz në rreth të virtytshëm?”, të organizuar nga Instituti GAP dhe Kosovo 2.0, u konstatua se 80 për qind e qytetarëve të anketuar nga UNDP-i besojnë se lidhjet familjare, ato partiake dhe ryshfeti janë kusht për punësimin në institucione publike

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 26 JANAR - Tetëdhjetë (80) për qind e qytetarëve të Kosovës të anketuar nga UNDP-i besojnë se lidhjet familjare, ato partiake dhe ryshfeti janë kusht për punësimin në institucione publike, kurse vetëm në 33 nga 85 raste është respektuar rekrutimi i këshilluar nga profesionistët e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë. Kështu u tha në diskutimin virtual me temë “Rekrutimet (jo)meritore në sektorin publik: a do ta ndryshojnë institucionet e reja rreth vicioz në rreth të virtytshëm?”, të organizuar nga Instituti GAP dhe Kosovo 2.0. Gjatë këtij diskutimi u tha se angazhimi politik nuk duhet të jetë garantues për vendin e punës, kurse u bë me dije se Mbretëria e Bashkuar do ta vazhdojë projektin e saj për t'i ndihmuar institucionet publike për rekrutimin e stafit edhe gjatë tri viteve të ardhshme. Drejtori i hulumtimeve në

Institutin GAP, Jeton Mehmeti, ka bërë me dije se ka një numër shumë të vogël të qytetarëve që besojnë se rekrutimi i punëtorëve në sektorin publik bëhet në bazë të meritokracisë. Mehmeti ka prezantuar të gjeturat kryesore të raportit “Rekrutimet jomeritore në institucionet publike”. Ai ka thënë se dukuria e nepotizmit ka ndikuar në uljen e besimit të qytetarëve në proceset e punësimit. Sipas anketës “Pulsi Publik”, vetëm 19.5 për qind e të anketuarve konsiderojnë se punësimi në sektorin publik bëhet në baza meritore dhe se 80.7 për qind mendojnë se punësimi në sektorin publik nuk bëhet në baza meritore. Sipas të anketuarve, faktorët kryesorë jomeritorë për t'u punësuar në sektorin publik janë: lidhjet familjare (30.8 për qind), lidhja partiake (30.4 për qind), ryshfeti (13.8 për qind), miqtë dhe, në një masë më të vogël, pamja fizike. Vetëm 19.5 për qind besojnë se arsimiti, aftësimi profesional dhe

përvoja profesionale janë faktorë të rëndësishëm për t'u punësuar në sektorin publik. E ndër vendet më atraktive janë pozitat nëpër borde të kompanive publike, ku për shkak të të ardhurave të larta mujore, përgjegjësisë së shpërndarë dhe llogaridhënies minimale ndaj publikut, për partitë në pushtet, bordet janë parë më shumë si mundësi punësimi për anëtarët e partisë dhe familjarët tyre sesa si një mekanizëm për menaxhimin e duhur të atyre ndërmarrjeve.

Kurse Luigi Brusa, përfaqësues i Bashkimit Evropian në Kosovë, ka pohuar se përgjithësisht në Ballkanin Perëndimor cilësia e burimeve njerëzore, në veçanti në institucionet qeveritare, nuk është në nivelin e duhur. Për këtë, Brusa tha se performanca më e mirë do të marrë financim më të mirë.

Ai ka deklaruar se në Kosovë nuk ka përgatitje të mirë të projekteve dhe se disa nga to do të shtyhen. Për Brusën, nëse nuk ka rekrutim të bazuar në meritë, atëherë nuk do të ketë mungesë të madhe të profesionistëve, të cilët do të kalojnë në sektorin privat apo do të shkojnë jashtë vendit. Kjo, sipas tij, është zhgënjyese dhe e papranueshme. Sipas tij, problemi kryesor është fakti se Kosova nuk ka punësim të bazuar në meritë. “Unë jam në Kosovë që katër vjet dhe ndjenja është që shumë herë merita nuk është vlerësuar dhe lidhja, asociimi me politikën ekziston. Dhe, iniciativa e Ambasadës Britanike është

përkrahur me fjalë, me pallavra nga politika e Kosovës. Them me fjalë sepse kur vjen puna të përzgjidhen kandidatët më të mirë, ata shpërfillen dhe, natyrisht në parlament kur ka emërimet, deputetët nuk votojnë sepse kanë një motiv të qartë, sepse marrin urdhër nga partitë politike. Nuk po bëj me gisht nga një parti por, për fat të keq, mentaliteti klanor në Kosovë është një sëmundje e keqe”, u shpreh ai. Sipas tij, njerëzit e politikës nuk janë në gjendje të identifikojnë një person të duhur. Brusën ka thënë se Kosova në këtë mënyrë po e dëmton veten. E në shtetet e vogla siç është Kosova, Brusa ka theksuar se do të duhej të ishte më lehtë që të mbështeten parimet e transparencës. “Unë kam mësuar nga raporti që vetëm 33 nga 85 raste rekrutimi i këshilluar nga projekti nga profesionistët e Mbretërisë së Bashkuar janë respektuar dhe kjo është për keqardhje. Performanca e Kosovës në këtë drejtim është e tmerrshme. Dhe, për këtë rekomandoj që njerëzit të kërkojnë nga politikanët një transparencë më të madhe sepse ajo është mënyra që ju të përfshihenit aktivisht. Këshilla numër një është votoni, numër dy mendoni për transparencën, për ndershmërinë, për meritat. Ka deputetë që në të kaluarën kanë ngritur shqetësimin për këto parime. Pavarësisht në cilën parti jeni, mbështetni deputetët që kanë qenë të gatshëm t'i

mbështesin parimet e qeverisjes së mirë”, u shpreh ai.

E për panelistin Agim Maraj shpërfaqja e fenomeneve negative është sukses më vete i projektit të Ambasadës së Britanisë. Ai ka bërë me dije se planifikojnë që të angazhohen edhe në tri vjetet e ardhshme për rekrutimin në institucionet publike në Kosovë. “Sipas anketës të UNDP-së, afër 80 për qind e të anketuarve mendojnë se emërimet janë politike. Kjo është shumë e rrezikshme dhe duhet të ndryshojë. Profesionistët nuk duhet parë politikën apo angazhimin politik si mënyrën e vetme për t'u punësuar. Nuk duhet të jetë politika garantuese për vendin e punës për profesionistë të ndryshëm. E pikërisht projekti britanik ka bërë që numri i atyre që aplikojnë, të arrijë të katërfishohet. Kjo tregon e Kosova ka burra dhe gra të afta, por që nuk kanë besim në institucionet e Kosovës dhe këtë besim po e shprehin vetëm në proceset ku ne jemi të angazhuar”, u shpreh ai. Edhe Visar Prebreza nga BIRN ka deklaruar se rekrutimi pa meritokraci po e dëmton shumë Kosovën. Ai ka bërë me dije se probleme me nepotizmin dhe klientelizmin gjatë rekrutimit ka pasur edhe në institucione më të vogla, siç janë komunat. “E kemi parë që kostoja e emërimeve jomeritore është goxha e madhe, përkthehet edhe në miliona”, është shprehur Prebreza.

Pas reshjeve të borës, Ministria e Infrastrukturës intervenon në mirëmbajtjen e rrugëve

PRISHTINË, 26 JANAR (ER) - Ministria e Infrastrukturës ka njoftuar qytetarët se kompanitë e mirëmbajtjes kanë intervenuar me kripë për shkak të temperaturave të ulëta si dhe kanë bërë pastrimin e erodimeve të shkaktuara pas reshjeve në rrugë për shkak të sigurisë në komunikacion. Sipas

kësaj ministrie, ka pasur intervenime për largimin e borës në të gjitha rrugët nën përgjegjësi të Ministrisë së Infrastrukturës: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjiilan si dhe në dy autoudhët "Arbën Xhaferi" dhe "Ibrahim Rugova". "Të gjitha rrugët janë të lira për


qarkullim, përveç rruga nacionale N2-QMI-ja ka rrjedhje të ujërave dhe paraqet pengesa në qarkullimin normal të komunikacionit. Në këtë vend do të intervenohet porsa të përmirësohen kushtet atmosferike, për ta zgjidhur problemin që paraqitet në rastet kur ka reshje të mëdha të shiut.

Kompania projektuese që është e kontraktuar nga Ministria e Infrastrukturës do ta krijojë një plan për shkarkimin e këtyre ujërave dhe do të intervenohet për ta tejkaluar këtë problem të vjetër. Ndërsa në drejtimin Kamenicë-Strezoc në fshatin Hajnoc rruga është mbyllur për shkak të dëmtimit të urës nga

vërshimet. Në këtë segment rrugor është duke u punuar për vendosjen e urës metalike nga Forca e Sigurisë së Kosovës. Lusim të gjithë qytetarët e Kosovës të kenë kujdes gjatë ngasjes dhe t'iu përshtaten kushteve atmosferike", ka njoftuar Ministria e Infrastrukturës.



Olmstead premton mbështetjen e ShBA-së për realizimin e projekteve energjetike



PRISHTINË, 26 JANAR (ER) - Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), Muharrem Nitaj, ka pritur të martën në takim drejtoreshën e Millennium Challenge

Corporation (MCC), Sarah Olmstead. Gjatë takimit u diskutua rreth punëve të para të grupit punues për sektorin e gazit në Republikën e Kosovës.

Ministri Nitaj e falënderoi drejtoreshën e MCC-së për mbështetjet që Shtetet e Bashkuara të Amerikës po i japin Kosovës për realizimin e projekteve zhvillimore përmes

programit të MCC-së. Sarah Olmstead ka premtuar mbështetjen e ShBA-së për realizimin e projekteve energjetike, duke u mbështetur në strategjinë e

energjisë së Republikës së Kosovës. Ky ishte takimi i parë pas themelimit të grupit punues për sektorin e gazit në Republikën e Kosovës.

Zgjedhjet e jashtëzakonshme, në situatë të jashtëzakonshme, dështimet në parashikime



Behxhet Sh. SHALA -BAJGORA

Lëvizja Vetëvendosje: LV-ja llogaritet favorite për t'i fituar zgjedhjet e jashtëzakonshme të datës 14 shkurt 2021. Edhe subjektet e tjera politike në heshtje janë pajtuar për këtë, ndonëse publikisht, që të gjitha deklarojnë se do të jenë fituese. Albin Kurti, Xhigis Kani i LV-së tërë potencialin intelektual dhe politik e ka përqendruar për të siguruar një fitore bindëse, apo siç thotë ai, do t'i sigurojë shumicën e deputetëve shqiptarë e që i bie mbi 50 në mënyrë që ta ketë tërë pushtetin. E ka përpiluar një listë të cilën nuk do të ishte në gjendje ta bëjë as Hiçoku, Agata Kristi, Spilbergu apo Quentin Tarantino. Në atë listë i gjeni të gjitha profilet politike, parapolitike, intelektuale, konstruktive, destruktive, të qendrës, të majta, të djathta, të deklasuar, të rehabilituar, të hurit e të konopit, deri tek ata të Hamamit të Hyrës. E ka integruar listën e Vjosës, jo për t'u forcuar politikisht, por për të fituar në aspektin psikologjik. Po bombardon me shifra, matematikisht të mundshme, logjikisht të pamundshme. Nëse prej 100 deputetëve shqiptarë deklaroni se do t'i keni 61, atëherë e kemi një fenomen përtej optimizmit. Në planin e luftës psikologjike, Albin Kurti dhe LV-ja janë të pakonkurrencë. Tash, pas numrit të 61 deputetëve që do t'i fitonte LV-ja me Listën Anës Vjosës, anës Bunës, disi është krijuar një situatë kur shifra prej 50 deputetëve të LV-së po duket thuhet normale.

Me 51 deputetë të Vjosës dhe Bunës (Binit), pas një tregtie me pakicat dhe me, së paku 10 deputetë të AAK-së, ky koalicion pasgjedhor do të merrte tri poste kryesore: presidentin, kryeministrin dhe kryetaren e Kuvendit. PDK-ja dhe LDK-ja do të mbeteshin në opozitë. Realisht, LV-ja dhe Lista Vjosa do të dëshironin ta kenë partnere LDK-në, të nënshtruar, të fyer, të poshtëruar dhe të qëruar nga Isa Mustafa, Agim Veliu dhe të tjerët e LDK-së që nuk pajtohen me ideologjinë dhe frymën e Haxhi Qamilit, të konvertuar në vendvendosës. Po, jam i bindur se skenari do të jetë ndryshe. Mendoj se LV-ja me Anës Vjosës i fiton afërsisht 38 për qind të votave, plus - minus, marzha e gabimit. Po flas për situatën tani, më vonë edhe mund të ndryshojnë për qindjet. Realisht, si përkrahës i

LV-së, në kohën kur fasulja hahej kokërr për kokërr e që nga ajo kohë ka mbetur vetëm gjysma e akronimit, me sinqeritetin më të madh do të dëshiroja që LV-ja t'i fitojë 81 vota shqiptare. Këto janë arsyet:

1. LV-ja dëshiron të ketë tri poste kryesore. Këto vota ia mundësojnë këto pritje dhe synime.

2. Me 81 deputetë do të përjashtohet mundësia për shantazhim nga Lista Serbe dhe do të relativizohet maksimalisht roli i LS-së kundër Kosovës dhe qytetarëve të saj sikur që do të shndërrohej vetëm në rregëzinë të Serbisë. Asgjë më tepër.

3. Me 81 vota, LV-ja do të ishte në gjendje ta përfaqësojë Kosovën në bisedime me Serbinë, pa pasur nevojë për të tjerët, të arrijë një marrëveshje që mendon se është më e mira, të mos bëjë kompromis, të kalojë në Kuvend çdo marrëveshje ndërkombëtare dhe të tjera.

4. Me 81 vota në Kuvend të Kosovës dhe me tri poste në pronësi të LV-së, do të emëroheshin ambasadorë, do të emëroheshin apo shkarkoheshin gjykatës dhe prokurorë, si kusht, sipas LV-së për reforma të thella në të gjitha fushat dhe krijimin e kushteve për ta luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar apo, siç kanë dëshirë ta thonë, ta çkapin shtetin dhe institucionet për t'i kapur vetë!

5. Me 81 vota të LV-së dhe të Anës Vjosës do të krijoheshin kushtet dhe mundësitë që vendimmarrja për çdo gjë të jetë e këtij koalicioni dhe nuk do të mund të pengoheshin me asgjë nga të tjerët.

Këtë e them me sinqeritetin më të madh dhe jo nga dëshira që të dështojnë sikur mund edhe të dëshirojë dikush. Sepse, dështimi do të na kushtonte të gjithëve, ndërkaq dështakët e mundshëm do ta gjenin një shtegdalje. Por, sipas analizës sime, nuk e shoh këtë zhvillim; Vjosa Osmani mund të jetë kryetare e Kuvendit, në rastin më të mirë. Nëse LV-ja i siguron 81 vota, e që unë dyshoj shumë (pa koalicion me një apo dy parti shqiptare), atëherë tregimi ndryshon! Nëse LV-ja nuk i siguron, së paku 45 deputetë, do të ketë problem ta formojë edhe qeverinë. Nëse LV-ja e udhëheq Qeverinë e Kosovës unë do ta përkrah çdo sukses të saj dhe nuk do t'i gëzohem aspak dështimit eventual. Mirëpo, duke e parë përbërjen e Listës së LV-së, i kam rezervat dhe dyshimet e sidomos gjuhën përjashtuese që po e përdorin. Shpresoj se me kalimin e kohës do të ulen në tokën e bukës ndryshe, euforia e pakontrolluar apo edhe e menaxhuar mirë është biletë hyrëse për një autokraci personale dhe anarki institucionale. Duket

se Albini nuk e ka ndryshuar vetëm pamjen e jashtme. Uroj të jetë ashtu.

Lidhja Demokratike e Kosovës: Nuk ishte trajtuar asnjëherë si partnere e barabartë nga LV-ja. Ishte një synim që "kalaja" e LDK-së të merret nga brenda, me Vjosa Osmanin e të cilës do t'i bashkëngjiteshin pastaj kuadrot e tjera të LDK-së. Realisht, niveli dhe kuadri më i fortë që po e ndjek Vjosën, ditë dhe natë, në shi dhe borë, në furtuna dhe situata të qeta është Haxhi Qamili. Thënë shkurt, largimi i Haxhi Qamilit nga LDK-ja është humbje e madhe, me pasoja katastrofike dhe të pariparueshme për... Lidhjen Demokratike të Afganistanit. E rëndë, vërtet e rëndë, por vdekja është edhe më e rëndë! Po të kishte shkuar Vjosa Osmani e vetme në zgjedhje dhe po të regjistrohej si nismë apo parti politike para 4-5 muajsh, jam i sigurt se do ta kalonte pragun zgjedhor, pa asnjë problem. Kështu, mund dhe do të ketë përfitime politike personale për një kohë, në planin afatgjatë do ta pësojë politikisht. Nëse LDK-ja në zgjedhjet e ardhshme shtrihet për toke dhe bie, sipas disa analistëve dhe nxënësve të Armend Mujës, shëmbëlltë e një analisti të pavarur, në 10-12 për qind të votave e që është vetëm një "Ëndërr e një nate vere" e Anës Vjosës (Vjosa) dhe anës Bunës (Bini), atëherë Vjosën do ta keni në krye të një LDK-je të "reformuar". Nuk e besoj, as në imagjinatën më të shëmtuar se LDK-ja bie nën për qind të votave. Besoj se do të jetë rreth 23 për qind të votave, gjykuar sipas Listës për deputetë që e ka ruajtur brumin partiak dhe substancën e LDK-së. Nuk ka parti që është ndarë më shpesh dhe më shumë se LDK-ja e që ka arritur ta ruajë substancën e partisë. LDK-në e kanë dëmtuar Nexhat Daci, Fatmir Sejdiu kurse tani po e vulosë tripletën e ndarjes, Vjosa Osmani. LDK-në e ka shpëtuar historia e saj, struktura e ashtëzuar organizative, anëtarësia e saj dhe thirrja në frymën rugoviste sikur edhe, për së vdekuri, Ibrahim Rugova. LDK-ja ka vota në shtretërit ku ka shumë votues kurse kutia ku merr më së shumti vota është varri i Ibrahim Rugovës. Varrin e Ibrahim Rugovës po e përdorin si kuti votuese edhe Vjosa, Albini dhe Ramushi. LDK-në e ka shpëtuar nga ndarja e madhe dhe mbase edhe nga shkapërderdhja, politikani më pragmatik dhe më i shkathët, për mua, në 6 vitet e fundit, Isa Mustafa. Mund edhe të mos pajtoheni por kjo është bindja ime. Isa Mustafa, përkundër që LV-ja përdori ndaj tij gjithë arsenalin e dhunës me të cilën disponon gerila urbane në Kosovë, hiç këtu armatimin e

rëndë të FSK-së, përkundër sulmeve ndaj tij dhe familjes së tij, gjeti forcë dhe kurajë t'i tejkalojë të gjitha këto dhe të bëjë koalicion me LV-në. Në këto rrethana, askush nuk do të afrohej me LV-në. Shembja e madhe e LDK-së, për mua do të ishte befasia më e madhe e që nuk e besoj se do të ndodhë! LDK-ja mbetet kandidati më serioz për koalicion me LV-në, pas zgjedhjeve nëse AAK-ja nuk i fiton 10 vota e më shumë!

Partia Demokratike e Kosovës: Është në situatë kur i mungojnë liderët, ai historik siç e quanin Hashim Thaçin dhe Kadri Veseli që nisi të reformojë partinë dhe i cili, me vullnetin më të madh kishte gatishmëri ta shtynte para procesin e vetingut, formimin e një Gjykate Ndërkombëtare për Krimet e Serbisë në Kosovë, Qendrën e Eksodit sikur edhe Muzeun Memorial. PDK-ja e ka një përparësi sepse është e liruar nga gara apo imperativi për të fituar zgjedhjet. Vërehet një angazhim i madh në terren dhe në diasporë. Ka një numër standard të votuesve i cili nuk lëvizë shumë. Po vërehet përpjekja për një urbanizim politik dhe organizativ të PDK-së si dhe një distancim i lehtë nga e kaluara, në disa raste e shndërruar në folklor politik. Në zgjedhjet e fundit, kur të gjithë ishin kundër PDK-së, dhe kur fushata elektorale e partive tjera mbështetej ekskluzivisht në diskursin kriminal që i vishej PDK-së, doli relativisht mirë duke fituar 24 mandate. Tash, PDK-ja nuk po sulmohet aq shumë sepse qëllimi dhe kuptimi i sulmeve ndaj PDK-së që personifikohet në Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin janë në Qendrën e Paraburgimit të një Gjykate Raciste në Hagë. Mendoj se nëse PDK-ja arrin të ruaj votat e zgjedhjeve të fundit apo nëse silltet rreth atyre votave, do të konsiderohej si fituese e zgjedhjeve aq më parë që është goditur shumë dhe që gjasat janë të goditet ende. Sinqerisht besoj se dëmin më të madh PDK-së ia kanë bërë individë të papërgjegjshëm si dhe qëndrimi i gjatë në pushtet. PDK-ja ka nevojë t'i kalojë të gjithë rrahët e Ferrit të Dante Aligerit, të përfundojë në Purgator ku do të spastrohej nga ndotja që ia kanë bërë individë të papërgjegjshëm dhe të korruptuar në mënyrë që ta zë vendin e merituar në skenën politike të Kosovës. PDK-ja ka të kaluar patriotike, anëtarësia ka përmbytje patriotike dhe është e gatshme që të mbrojë në çdo kohë sakrificën e madhe për liri, çlirim dhe pavarësi të Kosovës. Sa më shpejt që të distancohet PDK-ja nga një e kaluar jo e pastër e disa individëve të saj, aq më shpejt do ta marr veten. Kosova ende nuk e ka përmbyllur çështjen e shtetësisë, as sa i përket ruajtjes së integritetit territorial e as në

aspektin e shtrirjes së sovranitetit prandaj Kosova ka nevojë për pjesën patriotike (Pjesa më e madhe) të PDK-së.

Nëse nuk ndodhin zhvillime të papritura, PDK-ja jo që do të bjerë në vota por mund të ketë ngritje të lehtë! PDK-ja e ka një përparësi që askujt nuk i vendosë vija të kuqe në ndërkohë që partitë e tjera assesi nuk lirohen nga ngjyrosja e vijave të bashkëpunimit me ngjyrë të kuqe ndaj PDK-së. PDK-ja po paguan për mëkatën e bërë nga disa çuna të fortë që janë thirrur në emër të PDK-së dhe të cilët nuk kanë pasur interes tjetër përveç interesit personal. PDK-ja ka nevojë të përforcohet në fushën e komunikimit me publik dhe me media e që deri më tani ishte dhe është Thembra e Akilit e PDK-së. PDK-ja, edhe këtë mandat duhet të refuzojë çdo ofertë për përfshirje në qeveri duke bërë opozitën konstruktive, në dobi të qytetarëve dhe të shtetit.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës: Është parti që nëse i fiton mbi 10 deputetë, do të bëhet përcaktuese për formimin e institucioneve të Kosovës sikur që do ta detyrojë Albin Kurtin t'i tregojë kartonin e kuq Vjosa Osmanit për postin e presidentit. AAK-ja i ka 10-12 anëtarë të partisë që, edhe në kushtet ekstreme do të luftojnë për ta siguruar postin e deputetit. Dhe, në të shumtën e rasteve e arrijnë këtë qëllim. Në kohën kur LV-ja e ka vetëm një lider që nuk kontestohet, nuk kundërshtohet, nuk zëvendësohet dhe që adhurohet, deri në idiolatri por, pa sakrifikuar shumë, AAK-ja i ka dy liderë të tillë, Ramushin dhe Dautin, pa të cilët partia do të ishte një kornizë, pa përmbajtje dhe për të cilët edhe do të sakrifikoheshin, po që nevoja. Edhe në AAK ka patriotë të devotshëm që e kanë bërë luftën dhe të cilët, përsëri do ta bëjnë, po që nevoja. AAK-ja e ka më të fuqishëm krahun ushtarak, se atë politik sikur që e ka edhe Anës Vjosës me Fatjon Boletinin e pecëve.

AAK-ja, nëse dalin parashikimet që i kam se, në rastin më të keq do të fitojë 10 deputetë, do ta ketë rolin që e ka LSI-ja e Ilir Metës në Shqipëri. Pa AAK-në nuk do të bëhet asgjë prandaj edhe Ramushi e ka blerë smokingun me flutur, për president, nëse në ndërkohë nuk do të ketë dridhje toke, në Pakistan, p. sh. Apo nëse Donika Gërvalla nuk tërhiqet nga kushti i vënë Albin Kurtit, se nuk mund të ketë koalicion me PDK-në, AAK-në dhe LDK-në, me Isa Mustafën dhe Agim Velion. Është me rëndësi të thuhet se asnjë Donikë nuk është ndarë mirë me AAK-në në kohën kur Donika Kadaj, për shumë gjëra është Ajnshtajni për Donika Gërvallën! Mund edhe të gaboj.

Aziz Kelmendi dhe enigma e vrasjeve pa luftë në kohë robërie (11)

Rrëfimi i Afrim Mehmetit për rastin e Paraqinit



Lulzim SAHITI

AFRIM MEHMETI: Isha 18-vjeçar kur nisa shërbimin e rregullt ushtarak, të cilin e kisha përfunduar më 14 shtator 1987 dhe më lejuan t'i vesh rrobat civile. Mirëpo, sapo dola nga porta kryesore e kazermsë u bë arrestimi im nga Policia Ushtarake. Policët më kanë përplasur për një muri të një shtëpie, afër po të njëjtës kazerme, ku veç kisha qëndruar dhjetë ditë. M'i lidhën duart dhe më mbajtën të shtrirë në tokë për njëzet deri tridhjetë minuta. Gjatë kësaj kohe disa qytetarë serbë kalonin afër meje. Më kujtohet që disa nga qytetarët kërkonin nëse këta kanë nevojë për t'i ndihmuar policët ushtarakë. Por një gjë e tillë nuk ndodhi, pasi ata nuk pranonin dhe për një moment erdhi një automjet me sinjale të Policisë Ushtarake, në të cilin më futën dhe më dërguan në paraburgim, ku ndodhej Burgu Ushtarak i Nishit. Futja në këtë burg u pasua me një dhunë fizike nga shufrat, shqelmat derisa zhvishesha nga rrobat civile, rroba këto që i kisha veshur para një ore dhe veshja po të njëjtat rroba ushtarake që veç i kisha hequr para një ore. Dallimi ishte se këto rroba ushtarake tani ishin pa rrip dhe këpucët pa lidhëse. Më dërguan në qeli pothuajse zvarrë duke më fyer në të gjitha aspektet familjare dhe kombëtare, duke potencuar gjithnjë si ndihmës i Aziz Kelmendit në serbisht "Pomagaq Aziz Kelmendija". Me një gjysmë vetëdije, pasi u futa në qeli, i dëgjova disa këshilla nga drejtori i burgut për rregullat shtëpiake. Realisht një arrestim të tillë e prisja, sepse që nga 2-3 shtatori më kishin marrë në pyetje, deri një ditë para se të më lironin, ashtu siç më liruam dhe pastaj më arrestuan. Por unë ndryshe nuk pata mundësi të veproja, veç t'i vesh rrobat civile, ta pranoj fletëleshimin dhe të dorëzohem kur ata më dolën përpara.

Ishin dy oficerë që filluan të më merrnin në pyetje, njëri ishte me gradën major e tjetri nënkolonel që tash emrat e tyre nuk më kujtohen. Hetimet e tyre bëheshin duke më marrë në pyetje gjatë gjithë ditës, ndonjëherë deri në orët e vona të mesnatës. Këta oficerë nuk përdornin dhunë fizike, përveç insistimeve për të pranuar ndonjë rol timin, në ndihmë dhe vrasje bashkë me Azizin. Ishte ngarkesë e rëndë psikike të jesh me dikë duke insistuar për diçka që nuk e kishe bërë. Për atë rezistencën time që bëja kishte një metodë tjetër që ata e praktikonin. Thërrisnin drejtorin e burgut, që quhej Stanko dhe i thoshin merre e dërgoje në qeli

sepse ky s'po bashkëpunon. Çfarë ndodhte më tutje? Porsa hyja në korridorin e qelive, të ofronin një kovë me ujë dhe një peshqir, që edhe sot e mbajë në mend se çfarë ngjyre dhe sa i madh ishte. Përkulesha në gjunjë dhe nga fillimi i korridorit filloja ta pastroja. Gjatë pastrimit, unë pozitën e kisha në gjunjë e në duar kisha peshqirin, me të cilin detyroheshja ta pastroja korridorin që ishte nga betonit i lustruar. Gjatë pastrimit një gardian më qëndronte prapa, kurse një tjetër para meje. Këtu fillonte edhe dhuna fizike. Gardianët mbanin në dorë shufra gome, të cilat i përdornin gjatë gjithë kohës duke na rrahur. Njëri na godiste nga mbrapa, kurse tjetri nga para. Ishte dhunë e tmerrshme sa që ndonjëherë nuk arrija ta mbaja as peshqirin në dorë nga dhuna e përdorur me anë të shufrave të gomës. Lëvizja ime lejohej aq sa gardiani bënte lëvizje dhe ndonjëherë ky pastrim zgjatej deri një orë, për një korridor rreth 10 deri 15 metra i gjatë dhe i gjerë diku 2 metra. Lirohesha nga pastrimi vetëm atëherë kur të njëjtin veprim kërkonin ta kryente dikush i radhës nga bashkë të burgosurit e tjerë të akuzuar për rastin e Paraqinit.

Të kuptohemi kjo formë e dhunës bëhej vetëm për një arsye që po nuk fole te hetuesit dihej çfarë të priste. Se kush ishte i radhës nuk e dinim. Edhe pse ishin në një burg të përbashkët, secili nga ne nuk e dinim për njëri-tjetrin se ku gjendeshim.

Gjatë këtyre veprimeve, ndonjëherë gardianët nuk arrinin t'i përmbahen vetëm dhunës me shufra gome dhe në një rast të caktuar për t'i kënaqur epshet e tyre shtazarake njëri nga gardianët më shqelmon me këmbë në pjesën e përparme të fytyrës, ku me këtë rast më pëlçiti gjaku në nofullën e epërme të dhëmbëve dhe pjesën e hundës. Forma e goditjes në këtë pjesë ishte e lehtë për ta sepse unë isha në pozitën në gjunjë duke pastruar korridorin. Më është dhënë ndihma e parë diku në qytet dhe më kanë kthyer në qeli përsëri. E mbaj në mend se kisha dhimbje të mëdha. Pas një jave apo dhjetë dite, ky problem më kaloi. Me thënë realitetin, kjo ishte një e mirë në fatkeqësi sepse për katër ditë sa isha i sëmurë, nuk u mora në pyetje dhe nuk e pastrova korridorin. E vetëkuptueshme nuk pësova as dhunë fizike. Por edhe qëndrimi në qeli ishte sfidues. Në një qeli kishte një shtrat dhe një tavolinë me një stol të vogël të mbështetur për muri. Gjatë qëndrimit në qeli, duhej të ishe i ulur, ku duart duhej të vendoseshin mbi tavolinë dhe kokën duhej të kishte të drejtuar nga muri. Lëvizjet nuk ishin të lejuara. Nuk ke pasur mundësi të lëvizje sepse ishe nën vëzhgim të vazhdueshëm nga gardianët e burgut dhe mosrespektimi i këtij rregulli pasohej me ndonjë ndëshkim që në këto raste zakonisht bëhej me

përdorim të dhunës fizike. Dhunë tjetër e vazhdueshme ishte kur të nxirmin nga qelia për tualet apo për ndonjë nevojë tjetër ditore siç ishte dërgimi tek hetuesit etj. Isha i detyruar në çdo kënd të qelisë e të burgut të ndalesha, të mbajë kokën poshtë, duart mbrapa dhe lëvizjet duhej të bëheshin vetëm me urdhrin e gardianit. Përveç urdhrit për lëvizje pësonim edhe dhunë fizike duke na goditur me shufra në anën e majtë dhe të djathtë të trupit. Këtë dhunë fizike, gardiani e bënte me majën e shufrës duke mbajtur

thanë, duhet veç të vërtetën të tregosh dhe fillojnë të më bëjnë pyetje që kishin të bëjnë me ngjarjen. Për një moment filloi të më dridhej trupi e veçanërisht duart dhe sytë të më lotojnë. Pata një ndjesi të trupit të lodhur apo të plogështisë ekstreme. Jam ngritur dhe me forcë kam larguar të gjitha telat, ndërsa personeli që ishin me këtë aparatë filloj të kërkojë ndihmë nga gardianët kinse për mos dëgjueshmëri. Më morën dhe më futën në qeli dhe pas njëzet minutave në të dy duart sipër mu



Afrim Mehmeti, komandant i Qendrës për Stërvitje Kolektive në FSK

shufrën në mes të saj. Këto goditje ishin goxha të forta dhe gjithnjë për një periudhë të caktuar mbetnin njolla në trupin tim.

Pas një muaji apo dy, nuk jam i saktë në kohë, më nxorën nga qelia dhe më dërguan në njërin nga dhomat, ku pashë dy njerëz. Ata më thanë të ulem në këtë karrige. Unë u trishtova kur e pashë atë karrige, me disa tela të zgjatur rreth saj sikur doja të refuzoja të ulem. Pyeta pse çfarë është kjo? Njëri nga ata mu përgjigj duke më thënë se është detektorë i gënjeshtrove. Unë kam për të bërë disa pyetje, ti duhet t'i përgjigjesh pyetjeve te mija. Unë realisht nuk kisha pasur njohuri për këtë lloj aparature. Në mendjen time, thashë shumë mirë qenka kjo tash mund të tregoj saktë situatën. U ula, mi vendosën disa nga telat në kokë dhe disa në duar e këmbë. Më

shfaqën disa plasaritje të vogla dhe kam kërkuar ndihmë. Shumë shpejt kanë ardhur një staf i tërë në qeli. Me ta ishte edhe njëri nga hetuesit e mi. Më pyetën se çfarë problemi kam dhe ju tregova për duart. Për një kohë të shkurtër më kanë dërguar në një objekt, ku kam parë personel mjekësor ushtarak, bashkë me mua ishin dy gardianë dhe drejtori i burgut. Më kontrolluan sytë dhe duart. Për duart nuk kishin ndonjë konstatim, ndërsa për sytë thanë që i ka të çregulluar. Më dërguan prapë në qeli dhe mi kishin caktuar një lloj të barnave. Këto barna i përdorja në prezencë të personelit të burgut. Kisha shqetësim të veçantë për duar. Një mjek që bënte vizitë nganjëherë në burg, me një rast ishte bashkë me drejtorin e burgut dhe ai po e pyet mjekun: "Çfarë u bë


me duar se akoma po i lëngojnë". Unë vërtet nuk kisha dhimbje, por të lënduara i kisha akoma. Mjeku po i thotë drejtorit të burgut: "Nuk janë asgjë, i ka djegur me cigare!". Që vërtet forma e plasaritjeve ngjasonte me djegie.

Përveç hetimeve që kishim çdo ditë, herë pas here na dërgonin edhe te gjykatësi hetues. Pas deklaratës që dhashë, më pyeti kinse për shëndetin, kishte dëgjuar për të gjitha ato që më kishin ndodhur dhe i tregova se jam duke përdorur terapi. Aty e kuptova se ajo terapi është e rëndë sepse gjykatësi i tha drejtorit të burgut nëse vazhdohet me përdorimin e këtyre branave ndaj tij, gjykimi nuk mund të mbahet. Unë pas një jave kam ndërprerë barnat. Nisa të mos i përdorë më, jo me dëshirën time, por nuk i sjellën më tutje. Fillova të mos bëjë gjumë të rehatshëm asnjëherë. Çdo natë ngrihesha nga gjumi duke ulëritur sa që nganjëherë nga gardianët e burgut pasonte edhe dhuna fizike, kinse për shqetësim të të tjerëve me qëllim.

Afrim Mehmeti, komandant i Qendrës për Stërvitje Kolektive në FSK

Gjatë hetimeve, gjykatësi hetues Marinko Radenković, kapiten i klasës të parë e kishte formuluar një deklaratë shumë mirë ku thuhet: "Aziz Kelmendi në tubime më së shumti ka folur për faktin pse Kosova duhet të bëhet Republikë. Ne jemi pajtuar me të dhe jemi marrë vesh si të realizohet kjo, tha Afrim Mehmeti". Deklarata në fjalë është lexuar para meje dhe unë jam pajtuar plotësisht me te. Këtë deklaratë timen i gjithë personeli hetues nuk e kishte pritë mirë. Unë realisht e kam bërë për të vetmen arsye. E para nuk besoja se do t'i shpëtojmë pushkatimit dhe më keq e dija që nuk kishte ku të shkonte. Personeli i burgut, në shenjë revolte që edhe pas rastit të Paraqinit kam konsideruar se Kosova duhet të bëhet republikë, më kanë sjellë në qeli dy libra që kanë qenë për Enver Hoxhën, një ka qenë e shkrimtarit Ismail Kadare, e mbaj mend se ishte romani "Kështjella" dhe nja dy apo tri të tjera kam harruar çfarë ishin. Sipas tyre, unë isha i helmuar rëndë me nacionalizëm dhe irredentizëm dhe se jam njëri i rrezikshëm për shoqërinë Jugosllave. Tani kishim unë mund të lexojë këtë literaturë veç në burgje, se ti je i papranueshëm për shoqërinë Jugosllave. Këtë literaturë e kam pasur në qeli diku tri ditë. Të them të drejtën asnjëherë nuk e kam lexuar. Kush kishte vullnet për të lexuar kur gjatë gjithë kohës isha nën hetime me inspektorë!

Vetëm një javë para se të filloj gjykimi më është lejuar të kam avokat privat, ku familja ime kishte angazhuar avokatin Bajram Kelmendi, ndërsa avokat zyrtar kam pasur oficerin ushtarak, Novica Pejçiq nga i cili kurrfarë ndihme juridike nuk kam pasur. (Vijon)



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Superliga me superderbi

Në elitën e basketbollit të Kosovës zhvillohen sot (e mërkurë) dy ndeshje derbi. Fillimisht nga ora 15:00 takohen Peja dhe Bashkimi, kurse dy orë më vonë në kryeqytet mejdanin e ndajnë Sigal Prishtina - Golden Eagle Ylli. Dy ndeshjet e tjera të kësaj xhiro zhvillohen nesër (e enjte)



Prishtinë, 26 janar - Në mesjavë do të zhvillohet xhironja e 18-të e Superligës së Kosovës në basketboll. Sfidat e parë do të jetë ndërmjet Pejës dhe Bashkimit, dy rivalët e vjetër në basketbollin e Kosovës. Pejanët kanë 11 fitore dhe gjashtë humbje, kurse prizrenasit nëntë fitore dhe tetë humbje. Takim mjaft interesant është ndërmjet Sigal Prishtinës dhe Golden Eagle Yllit. Bardhekaltrit hyjnë në këtë ndeshje pas fitores ndaj Rahovecit, kurse therandasit kanë tri fitore në stinorin pranveror dhe

synojnë të vazhdojnë me fitore. Prishtinasit kanë pesë fitore dhe 12 humbje, derisa Ylli 11 fitore dhe gjashtë humbje. Përballja vendimtare cilësohet mes Vëllaznimit dhe Trepçës, dy skuadra që kanë nga katër fitore dhe 13 humbje dhe synojnë të mbesin në elitë, andaj kjo përballje do të jetë mjaft interesante. Xhironja e 18-të përmbillet me super sfidën ndërmjet Ponte Prizrenit dhe Rahovecit, dy skuadra që kanë grumbulluar nga 29 pikë apo 12 fitore dhe pesë humbje.

Fituesi i këtij takimi do të jetë në krye të renditjes së elitës të basketbollit të Kosovës.

SUPERLIGA - Xhiro 18

Të mërkurën takohen:
15:00 Peja - Bashkimi
17:00 Sigal Prishtina - Golden Eagle Ylli

Të enjten takohen:
15:00 Vëllaznimi - Trepça
17:00 Rahoveci - Ponte Prizreni

SHKURT

Shaqiri refuzon ofertën e Hertha Berlinit

Xherdan Shaqiri ka refuzuar ofertën e Hertha Berlinit gjatë këtij afati kalimtar, raporton "Sky Germany". Klubi gjerman dërgoi ofertë në drejtim të futbollistit nga Gjilani, për ta huazuar deri në fund të sezonit, por është hedhur poshtë nga Shaqiri. Ky i fundit ka bërë vetëm 11 paraqitje këtë sezon në të gjitha garat duke shënuar një gol dhe asistuar në tre të tjerë.

Ymeri dhe Jetullahu përforcojnë 2 Korrikun

Skuadra e 2 Korrikut ka arritur marrëveshje me dy futbollistë. Bëhet fjalë për sulmuesin qendror Drin Ymerin dhe mesfushorin Labinot Jetullahun. Lajmi është konfirmuar nga faqja zyrtare e klubit prishtinas në rrjetin social "Facebook". "Klubi i Futbollit '2 Korriku' njofton se ka arritur marrëveshje me sulmuesin Ymeri si dhe me mesfushorin Jetullahu. Të dy futbollistët janë bashkuar me skuadrën në Durrës, atje ku skuadra tash e tri ditë është akomoduar dhe po përgatitet për stinorin pranveror", thuhet në njoftimin e klubit që bën gara në Ligën e Parë.

Babai i Mustafit: Shkodrani nuk ka kërkuar shkëputjen e kontratës me Arsenalin

Qendërmbrojtësi shqiptar Shkodran Mustafi nuk ka kërkuar nga Arsenalin shkëputjen e kontratës. Këtë lajm e ka konfirmuar babai, njëkohësisht agjenti i Shkodran Mustafit, Kujtim Mustafi. "I kam lexuar ato spekulime se Shkodrani dëshiron ta shkëpusë kontratën. Të jemi të qartë, nuk ka bisedime për shkëputjen e kontratës. Fakti është se Shkodrani do të largohet në verë", ka thënë Kujtim Mustafi.

Bora ndërpret miqësoren Vëllaznimi - Besa

Reshjet e borës e kanë ndërprerë ndeshjen miqësore të fazës parapërgatitore në mes të Vëllaznimit dhe Besës. Skuadra kuqezë nga Gjakova ka njoftuar se ndeshja u ndërpre në minutën e 25-të kur rezultati ishte ende 0-0. Ndërprerja e ndeshjes u bë me kërkesë të trajnerit të Besës, ndërsa lojtarët e Vëllaznimit vazhduan stërvitjen aty, pavarësisht prej kushteve aspak të përshtatshme. Paraprakisht kjo ndeshje ishte planifikuar të zhvillohej në Pejë, por më pas u zhvendos në Shkugëz të Gjakovës.

Llapi përfundoi fazën përgatitore, rikthehet në Kosovë

PRISHTINË, 26 JANAR - Skuadra e Llapit e ka përfunduar fazën përgatitore në Turqi, kurse të martën në mbrëmje ekspedita e klubit lllapjan është rikthyer në Kosovë. Llapi që drejtohet nga trajneri Tahir Batatina e ka

vlerësuar të suksesshme fazën njëmbëdhjetëditore të përgatitjeve. "Me punë, angazhim, disiplinë dhe pa lëndime përmbyllëm fazën përgatitore prej 11-ditësh në Antalia. Një fazë që mund të

quhet e suksesshme për skuadrën ku, përveç stërvitjeve nga dy herë në ditë, arritëm të zhvillojmë edhe katër ndeshje kontrolluese, prej të cilave arritëm dy fitore, një barazim dhe vetëm një disfatë. Skuadra

rikthehet në Kosovë dhe pushon dy ditë për t'u rikthyer më pas me seancat stërvitore finale para ndeshjes së parë të Kupës dhe ndeshjeve të edicionit pranveror të Superligës", thuhet në njoftimin e KF Llapit.



Tare: Shqipëria mund ta arrijë vendin e dytë

TIRANË, 26 JANAR - Igli Tare në emisionin "Sport Time" e ka komentuar grupin e Shqipërisë në kualifikueset e Botërorit. Pavarësisht prej vështirësisë së grupit ku gjendet Kombëtarja kuqezi, ekzistojnë mundësitë për ta marrë vendin e dytë, që do të ishte arritje e madhe për

kuqezinjtë. "Unë nuk e shikoj si problem grupin. Të luash kundër Anglisë është e vështirë. Edhe kundër Polonisë dhe Hungarisë, gjithashtu. Është grup luftëtar. Shqipëria, nëse ia del, mund ta arrijë vendin e dytë. Çfarë të bëjnë më tepër se kaq sa kemi

arritur?! Ajo humbja me Lituaninë ishte diçka e keqe, por pastaj ia dolën ta arrijnë kualifikimin për në grupin B. Kombëtarja është ekip me lojtarë të rinj", ka thënë Tare. "Mbrotjtja është shumë e ekuilibruar, në nivel mbi mesatar. Në mesfushë e shikoj

pikën më të dobët, mungojnë dy lojtarë, që t'i japin jetëgjatësi këtij reparti. Bare është mirë, Gjasula me përvojë. Është një repart që e shikoj me pak vështirësi. Në sulm kanë disa lojtarë të rinj, plus Cikalleshin dhe Sadikun", ka shtuar Tare.



Hasani, pas prezantimit te Partizani: Gjithmonë kam dashur të luaj në Shqipëri

TIRANË, 26 JANAR - Ferhan Hasani është goditja e Partizanit në merkato. Klubi kishte arritur marrëveshje prej disa ditësh dhe fantazisti u pa në derbi dhe në sfidën kundër Teutës në stadium. Të martën ka ardhur edhe prezantimi i sulmuesit, i cili do ta mbajë numrin 24.

Në konferencë i pranishëm ishte edhe drejtori i përgjithshëm, Olsi Rama. Për Partizanin ky është afrimi i tretë i rëndësishëm. Hasani u shpreh se nuk është ende në formën e duhur, por premtoi se do ta japë maksimumin në fushë sapo t'i jepet mundësia. Ai tregoi se e njeh kampionatin shqiptar dhe se i kishin thënë se do të bënte gabim po ta zgjidhte Tiranën. "Kampionatin shqiptar e njoh mirë, pasi e kam ndjekur prej kohësh. Qëkur kemi nisur bisedimet kam filluar ta ndjek edhe më shumë. Për sa i përket anës sime, se nuk kam ndeshje në këmbët, dua të saktësoj se do të jem këtu për një kohë të gjatë. Do të bëj më të mirën në stërvitje për ta arritur formën. Si do të shkojë ky bashkëpunim nuk e di, atë do ta tregojë koha. Unë nuk do të jem ndryshe, do të jem si futbollistët e tjerë. Ju lutem, mos më trajtoni ndryshe", ka thënë Hasani. "Pse zgjedha Partizanin? Edhe Rama e tha më herët: kemi pasur bisedime të cilat kanë qenë të shkëlqyera. Kam pasur



dëshirë të luaj në Shqipëri. Jam shumë i lumtur që sot jam këtu. Kam pasur dëshirë të bashkohesha me Partizanin. Si e shoh sulmin e Partizanit? Të them të drejtën nuk e kam diskutuar këtë pjesë. Do ta vendosë trajneri se ku do të luaj dhe nëse do të luaj apo jo. Do ta jap maksimumin për ekipin", ka shtuar ai.

Më pas sulmuesi Hasani ka vlerësuar se niveli i futbollit shqiptar është rritur shumë vitet e fundit, çfarë dëshmon edhe fakti se disa ish-lojtarë të Shkëndijës tash janë pjesë e Superiores. "Është pozitive që ish-shokët e skuadrës sime të Shkëndijës kanë ardhur në Shqipëri. Kjo do të thotë se futbollit shqiptar është në nivele të larta. Ka qenë lart, por me ardhjen e lojtarëve cilësorë shtohet më shumë cilësia.

Ardhja e tyre tregon shumë për kampionatin shqiptar. Është një kampionat i fortë dhe jo si në Maqedoni. Pozicioni në fushë? Unë e shikoj vetën aty ku do trajneri. Mendoj se jam një lojtar si gjithë të tjerët. Do ta jap maksimumin për arritjen e objektivave. Nëse dalim kampionë apo jo, le t'ia lëmë kohës", ka deklaruar Hasani.

Në fund, ish-sulmuesi i Shkëndijës e ka zbuluar edhe bisedën telefonike me Ardian Cuculin. "Kur kishte zëra për kalimin tim te Tirana, Cuculi më mori në telefon dhe më tha se do të bëja zgjedhjen e gabuar. Më tha të zgjidhja Partizanin dhe jo Tiranën. A jam gati për debutim? Nuk e di, të them të drejtën, por do të shikojmë si do të jetë gjendja. Janë gjëra të trajnerit dhe stafit teknik", ka përfunduar Hasani.

Hamiltoni: Te McLareni do të kisha fituar vetëm një titull

LONDËR, 26 JANAR - Ndërkohë që të gjithë presin se çfarë do të ndodhë me Lewis Hamiltonin, se kur do të rinovojë me Mercedesin, piloti britanik ka bërë një përmbledhje të karrierës së tij. Ai e nisi atë në vitin 2007 me makinën McLaren, ku u renditi i dyti që në debutimin në Formula 1. Një vit më pasi ai u shpall kampion bote për herë të parë me McLarenin dhe në vitin 2012 u largua për të shkuar te Mercedesi. Këtu, britaniku fitoi gjashtë tituj kampionë bote dhe tashmë numëron 7 tituj në Formula 1, njësoj si Michael Schumacheri. "Ka pasur momente kur pyesja veten se kush e di se kur do të fitojë sërish. Ayrton Senna thoshte gjithnjë se nëse nuk rrezikon nuk bëhesh pilot.



Kam qenë pjesë e McLarenit që 13 vjeç, që ishte familja ime. Gjithsesi, kuptova se po të qëndroja më gjatë aty nuk do të doja më", ka thënë Hamiltoni. "E dija se duke ndryshuar makinë do të përshkoja një rrugë tjetër drejt rritjes time profesionale. Ndaj

zgjedha të shkoj te Mercedesi, që nuk kishte shumë suksese, por e ndihmova që të bëhej një 'top-team' dhe rezultatet erdhën. Rrezikova dhe fitova. Po të qëndroja te McLareni do të kisha mbetur me një titull, sot kam 7", ka deklaruar Hamiltoni.

SHKURT

PSG-ja ofron 15 milionë euro për Ramosin

Kampionët e Francës janë të etur ta transferojnë kapitenin e Real Madridit gjatë këtij afati kalimtar. PSG-ja i ka ofruar Sergio Ramosit kontratë trevjeçare me një pagë vjetore prej 15 milionë eurosh. Real Madridi i ka ofruar spanjollit 34-vjeçar vetëm kontratë dyvjeçare gjë të cilën ende nuk e ka pranuar qendërmbrojtësi. Ramosi me madrikenët ka kontratë deri në verën e këtij viti, ndërsa aktualisht është i lënduar. Ai këtë edicion ka luajtur 18 ndeshje në të gjitha garat dhe ka shënuar tri gola dhe ka kontribuar me një asistim.

Kloppi urgjentisht kërkon transferimin e Alabas

Jurgen Kloppi po e dëshiron me ngulm transferimin e David Alabas nga Bayern Muncheni. Mbrojtësi austriak ka refuzuar rinovimin e kontratës me skuadrën gjermane dhe po e kërkon largimin në këtë verë si lojtar i lirë. Por, sipas asaj që raporton "Daily Mirror", Klopp po insiston që Liverpooli t'i marrë shërbimet e Alabas në këtë afat kalimtar të janarit. Alaba kërkohet edhe nga Barcelona dhe Real Madridi.

Koeman: Messi dëshiron të luajë çdo ndeshje

Trajneri i Barcelonës, Ronald Koeman, ka folur lidhur me situatën e sulmuesit Lionel Messi. Argjentinasi mungoi në dy ndeshjet e fundit shkaku i kartonit të kuq që mori kundër Athletic Bilbaos në Superkupën e Spanjës. Koeman ka thënë se sulmuesi argjentinasi dëshiron të luajë çdo ndeshje. "Është i gatshëm, me energji. Për t'i fituar ndeshjet na nevojitet Messi në formë dhe në nivelin e tij. Ai dëshiron të luajë dhe të fitojë. Është mësuar të fitojë tituj. Është fitues dhe dëshiron të luajë çdo ndeshje. Nesër do të flas me të dhe do t'i tregoj skuadrës", ka thënë Koeman. Me fitoren ndaj Vallocanos të mërkurën në mbrëmje, Barcelona do të kualifikohet në çerekfinalen e Kupës së Mbretit.

Conte pezullohet për dy ndeshje

Antonio Conte nuk i ka shpëtuar dënimit pas përplasjes së ashpër verbale me gjyqtarin në fundin e ndeshjes kundër Udineses të luajtur të shtunën e kaluar. Gjykata Sportive ka pezulluar trajnerin e Interit për dy ndeshje, ndërsa ai duhet të paguajë edhe një gjobë 20 mijë euro. Në këtë mënyrë, Conte nuk do të jetë në bankinë për dy sfidat e ardhshme të kampionatit kundër Beneventos dhe Fiorentinës.

Lampardi: Ka qenë privilegj ta menaxhoj Chelsean

Frank Lampard u shkarkua të hënën nga posti i trajnerit të Chelseat. Pas shkarkimit, Lampardi ka reaguar duke i falënderuar tifozët për mbështetjen që i kanë dhënë për 18 muaj. Trajneri anglez ka shtuar se ka qenë privilegj i madh për ta drejtuar skuadrën ku ai ishte futbollist. "Ka qenë privilegj i madh dhe nder ta menaxhoj Chelsean, klub që ka qenë pjesë e madhe e imja për një kohë të gjatë. Së pari dua t'i falënderoj tifozët për mbështetjen e madhe që kam pranuar në 18 muajt e fundit. Shpresoj se e dinë çfarë nënkupton për mua. Jam krenar për arritjet që kemi bërë dhe jam krenar për lojtarët e akademisë që ia dolën në ekipin e parë dhe u paraqitën shumë mirë. Janë e ardhmja e klubit", ka shkruar Lampard. "Jam i zhgënjyer që nuk kisha kohë këtë sezon ta sjell klubin përpara dhe në vendin që i takon. Dua ta falënderoj Abramovichin, bordin, lojtarët, trajnerët dhe të gjithë në klub për punën dhe dedikimin, sidomos në këtë kohë. I uroj klubit suksese në të ardhmen", ka shtuar Lampard.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica
NPL - "Qendra Multifunkionale" SH.A.



e-mail: qendraomnisport@gmail.com

Në bazë të vendimit të Bordit të Drejtorëve, Ndërmarrja Publike Lokale "QENDRA MULTIFUNKSIONALE" SH.A., shpallë:

FTESË PËR OFERTË PËR DHËNIEN ME QERA – RESTAURANT me Hapësirat përcjellëse

Ftoheni që të Ofertoni për marrje në shfrytëzim me Qera të Hapësirës Afariste - Restaurant, me Hapësirat përcjellëse sipas Projektit – Kuzhinë, Depo, Tualetet (M dhe F), të cilat janë pronë e NPL "QENDRA MULTIFUNKSIONALE" SH.A.
Hapësira e Restaurantit jepet me Qera për personat juridik.

Nr.	Hapësirat me nr.	Destinimi	Sipërfaqja	Çmimi fillestar për m ² (pa TVSH)
1.	C2-301, 302, 303, 304, 305, 307, 308	Restaurant	361.50 m ²	4.00 €

Kushtet e Përgjithshme

1. Periudha e Qeradhënies është për 1 (një) vit, me mundësi vazhdimi.
2. Qeramarrësi me anë të Nënshkrimit të Kontratës me Qeradhënësin, është i obliguar që të bëjë parapagimin e një shumë monetare në vlerë të një Qeraje Mujore në llogari të Qeradhënësit.
3. Qeramarrësi është i obliguar që pas Nënshkrimit të Kontratës të bëjë sigurimin e mallit nga kompanitë e sigurimit.

Kriter për përzgjedhjen e ofertuesit me të favorshëm është:

1. Çmimi me i lartë i ofertuar se sa çmimi fillestar.
2. Funkcionalizimi i Restaurantit brenda afatit prej 30 ditësh.
3. Tarifa e aplikimit është **200.00 €** - ofertuesit të zgjedhur, e njëjta do ti kompensohet me faturën e parë të Qerasë, ndërsa Ofertuesit të përzgjedhur i cili tërhiqet nga Kontrata për Qera, nuk i kthehet tarifa e aplikimit prej **200.00 €**, ndërsa Ofertuesëve që nuk pagzjedhen iu kthehet tarifa e aplikimit prej **200.00 €**.

Tarifa e Aplikimit të paguhet në këtë Konto nr. të Ndërmarrjes: **1405000004847360**

Ofertuesit duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

1. Kopjen e Çertifikatës së Regjistrimit të Biznesit dhe numrit fiskal, (kopje)
2. Kopjen e një dokumenti identifikues të pronarit ose të përfaqësuesit të biznesit, (kopje)
3. Çmimin e ofertuar për m² i cili duhet të jetë pa TVSH (Ofertë)
4. Vërtetimin nga ATK-ja, që të dëshmohet se biznesi është aktiv,
5. Fletëpagesën për Aplikim.

Ofertat nuk do të merren parasysh nëse:

1. Ofertuesi i cili ka pasur Hapësira me Qera në NPL "Qendra Multifunkionale" SH.A. dhe nuk i është përmbajtur Kontratës së Qerasë ose ka obligime ndaj Ndërmarrjes,
2. Nëse oferta nuk i përmban të gjitha dokumentet dhe kushtet e kërkuara,
3. Nëse Oferta arrin pas datës së afatit të dorëzimit të ofertave të përcaktuara në Shpallje.

Personat Juridik të cilët duan t'i vizitojnë Hapësirat e lartcekura, mund t'a bëjnë këtë nga data: **26.01.2021**, deri me datën **04.02.2021** nga ora **10.00** deri në ora **15.00**.

Ofertat duhet të dorëzohen në Zarf të mbyllur deri me datën: **05.02.2021** në ora **12.00**, në zyrën e Arkivës së Qeradhënësit NPL "QENDRA MULTIFUNKSIONALE" SH.A.

Në pjesën e jashtme të Zarfit duhet të specifikohen:

1. Emri i Ofertuesit,
2. Nr i Hapësirës – Restaurant me Hapësirat përcjellëse sipas Projektit dhe
3. Adresat Kontaktuese, si: web-faqja, e-mail, nr. i telefonit.

Ofertat do të hapen nga ana e Komisionit të formuar nga NPL "Qendra Multifunkionale" SH.A. me datë: **05.02.2021**, nga ora **12:30**, në prezencën e ofertuesve, në Zyrë e Administratës/Drejtorisë së NPL "Qendra Multifunkionale" SH.A. në Mitrovicë.

Kërkesa (Aplikacioni) mund të kërkohet edhe përmes e-mail-it: qendraomnisport@gmail.com si dhe në formën fizike në zyrë e Administratës/Drejtorisë së NPL "Qendra Multifunkionale" SH.A.

U.D Krveshefi, Ekzekutiv

Sami Zeka, MArch



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA



Në bazë të nenit 57 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenin 4 dhe 5 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Oda e Mjekëve të Kosovës shpall këtë:

KONKURS

ZYRTAR/E ADMINISTRATIV/E PËR KOMISIONE TË PËRHERSHME

Numri i pozitave: 1 (një vend pune),

Nr. ref: 01/2021

Kohëzgjatja e Kontratës: 6 muaj (Orar i Plotë, Zëvendësim i Pushimit të Lehonisë)

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Ofron asistencë në kryerjen e punëve administrative për nevojat e punëve të Komisioneve të Përhershme të OMK-së;
- Pranon aplikacionet, kërkesat/ankesat nga palët drejtuar Komisioneve të Përhershme, kujdeset për mbarëvajtjen e procedurës administrative deri në shqyrtimin final të lëndës;
- Mirëmbanë dosjet, në formën fizike dhe elektronike si dhe data bazën e Komisioneve të Përhershme;
- Siguron materialet e nevojshme për mbarëvajtje të mbledhjeve të Komisioneve të Përhershme;
- Ndihmon anëtarët e Komisioneve në kontaktet me organet tjera të OMK-së si dhe palëve të treta;
- Kryen edhe punë tjera nga fusha e përgjegjësisë dhe specifikimeve të përcaktuara me Kontratën e Punës.

Shkollimi i kërkuar: Ta këtë të kryer shkollën e mesme (shkollë profesionale), përparësi konsiderohet shkollimi superior;

Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Një (1) vitë përvojë pune në administratë.
- Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerjen e detyrave të punës;
- Njohje e mirë e punës me kompjuter Word, Excel, Internet dhe mjeteve tjera teknike në zyrë, fotokopjuesi;
- Shkathësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, për të dhënë udhëzime dhe për të përcjellë informata tek të tjerët;
- Të jetë energjik, të ketë iniciativë dhe kreativitet duke ofruar ide të reja në çështje të ndryshme lidhur me procesin e punës;
- Të jetë fleksibil dhe t'u përgjigjet pozitivisht ndryshimeve;
- Njohja e gjuhës angleze konsiderohet përparësi;

Paraqitja e kërkesave:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e kërkuar dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Formularët për aplikim mund të shkakohen nga ueb faqja e OMK-së, www.omk-rks.org dhe të gjitha aplikacionet e plotësuar së bashku me kopjen e letërnjoftimit, kopjet e dëshmimeve për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat si dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit, mund të dorëzohen:

- Përmes e-mail adresës info@omk-rks.org apo
- Përmes postës në adresën "Instituti A" QKUK, kati II, 10 000 Prishtinë, RKS

Në subjekt të emailit të ceket pozita për të cilën aplikoni dhe emri, mbiemri juaj!

Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Veçim kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit dhe do të jetë i hapur nga data: **26.01.2021** deri më **10.02.2021**, ora **16:00**.

Për informata shtesë mund të kontaktoni në numrat e telefonit: **049/872-300** apo **038 / 544-872**.

Konkursi dhe aplikacioni për punësim janë të publikuara edhe në Ueb-Faqen e Odës: <https://omk-rks.org/>



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS



Drejtoria për Arsim dhe Edukim



Adresa : Malishevë
Rr.-Skenderbeu ", p.n
Email: dkaemalisheva@gmail.com

PRANUAR MË: 26-01-2021 Tel: 029-269-003

ACCEPTED ON: 26-01-2021

PRIMLJENO: M/80

Nr.No.Br. M/80

Datë: ___/___/2021

Nr:11/___

Drejtori për Arsim dhe Edukim në mbështetje të kontratës Kolektive neni 14 pika 7 nxjerrë këtë:

V E N D I M

Për anulimin e Konkursit të datës 25.01.2021 me nr: 11/76 dt, 25.01.2021

1. Anulohet Konkursi i datës : 25.01.2021 i shpallur në gazetën ditore Epoka e Re dhe webfaqe të Komunës për mësimdhënës të lëndës së Fizikës për 16 orë mësimi në javë në SHFMU" Dëshmorët e Fshatit Bubavec" në Bubavec

2. Vendimi hynë në fuqi pas nënshkrimit të tij

Arsyetim

Mbështetur në Kontratën Kolektive Neni 14 pika 7 për plotësim norme e në mungesë të numrit fizik për rekrutimin e punëtorëve të rijë në sistem, u vendos si në diapozitiv të këtij vendimi .

Vendimi u dërgohet:

1. U.D. Drejtorit të SHFMU" Dëshmorët e Fshatit Bubavec" në Bubavec z. Selim Kryeziu
2. Drejtorit të SHFMU" Ramadan Morina " në Damanek z. Zeqir Kastrati
2. Komisionit intervistues
3. Arkivit



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine
Ministry of Economy and Environment

Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë
për Kushtet Ndërtimore

"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin "Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".

Nr. prot: 4265/20 të datës 24.09.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

Posta rekomande:

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
Nderësa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:

<http://mmph-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
Suzana.goranci@rks-gov.net
Telefon: + 381 38 200 32 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Njomza Osman Kuçi shpall të pavlefshme diplomën e bachelor të lëshuar nga kolegji "Fama".

► Viktoria Asllan Bytyçi shpall të pavlefshme diplomën bachelor të lëshuar nga kolegji "Fama".

► Festim Qelavet shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Agim Rama shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Velija Rejhan shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX shf "Shari" Jabllanicë.

► Vilman Qovanaj shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren .

Ahmet Ponik shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Fadil Hisari" Prizren.

► D.P.Z. "Trevira-D" Daut Bajgora shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 600882014.

► Fatmir Shahini, B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së me nr. 330091968 Gjilan.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/giejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjzë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbrërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti

ÇMIMI: 5.99 €



DEKALOGU

nga Moisiu deri te Kieślowski

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN
novelë

Daut Dauti

Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjstruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuës i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4⁹⁹ €

ISBN 978-9951-780-10-0

ARMAGJONINI





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

